

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

***”QEVERISJA E MIRË NË FUNSKION TË
MENAXHIMIT TË MIRË LOKAL: STUDIM RASTI
KOMUNA E BOGOVINËS”***

KANDIDAT:

Farije Alija

MENTOR:

Prof. Dr. Memet Memeti

Tetovë, shkurt 2020

DEKLARATË NDERI

Deklaroj se punimi me titull ***"Qeverisja e mirë në funksion të menaxhimit të mirë lokal: Studim rasi Komuna e Bogovinës"***, është origjinal dhe se është rezultat i hulumtimit dhe analizave personale. Çdo punim i autorëve tjerë është përmendur dhe cituar në formën e duhur në këtë punim magjistrature. Për çdo dyshim dhe element plagjiature përgjigjem personalisht para çdo organi dhe institucioni në cilëndo formë, morale, materiale dhe penale.

Farije Alija,

Tetovë, 17.02.2020

ABSTRAKT

Qeverisja e mirë në funksion të menaxhimit efikas të burimeve në dispozicion dhe zbatimit të politikave të përshtatshme, vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore për shumë shtete në zhvillim, ndonëse rallëherë mund të arrihet në një qeverisje e cila do të përmbush me përpikshmëri parimet kryesore, sikurse: transparencën, përgjegjshmërinë, ligjshmërinë, paanësinë, barazinë para ligjit, si dhe dhënien e mundësisë së gjithë aktorëve për pjesëmarrje në procesin e zhvillimit qendror dhe lokal. Pra, shkoqitja e efekteve të qeverisjes së mirë në funksion të menaxhimit të mirë lokal, e njëherit implikimet në administrimin e kësaj qeverisje, respektivisht sa kjo e fundit ofron mundësi për aplikimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe si mund të administrohen në mënyrë që të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve, mbetet qëllimi kryesor i këtij studimi, respektivisht sa qeverisja e mirë kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës së gëzuar nga ana e të gjithë qytetarëve.

Fjalët kyçe: qeverisja e mirë, transparenca, përgjegjësia, llogaridhënia, efikasiteti, eficiency

ABSTRACT

Good governance in the function of efficient management of available resources and implementation of appropriate policies, continues to be one of the major challenges for many developing countries, although it can rarely be achieved in a governance that will fully meet key principles, such as: Transparency, responsibility, legality, impartiality, equality before the law, as well as enabling all stakeholders to participate in the central and local development process. So, the effects of good governance on the function of good local governance, as well as the implications in this administration of this governance, respectively how much this last one provides opportunities for applying the principles of good governance and how they can be administered in order to improve the well-being of citizens, remains the main aim of this study, namely how good governance contributes to improving the quality of life enjoyed by all citizens.

Keywords: good governance, transparency, responsibility, accountability, effectiveness, efficiency

PËRMBAJTJA:

HYRJE DHE LËNDA E HULUMTIMIT

• Hyrje.....	7
• Qëllimet e hulumtimit.....	9
• Hipotezat.....	11
• Metodologjia.....	11
• Rëndësia e punimit.....	12

KAPITULLI I: QEVERISJA E MIRË

I. 1. Qeverisja e mirë: definicioni, kuptimi, rëndësia.....	13
I.2. Parimet e qeverisjes së mirë.....	17
I.2.1. Transparenca.....	17
I.2.2. Përgjegjshmëria.....	20
I.2.3. Pjesëmarrja.....	22

KAPITULLI II: KORNIZA JURIDIKE E VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

II.1. Kompetencat e vetëqeverisjes lokale.....	26
II.2. Korniza juridike mbi parimin e qeverisjes së mirë.....	29
II.3. Mënyrat e financimit të vetëqeverisjes lokale.....	32

KAPITULLI III: KOMUNA E BOGOVINËS DHE ORGANIZIMI I SAJ (KËNDVËSHTRIMI)

III.1. Mënyra e organizimit.....	35
III.1.1. Sektori për urbanizimi.....	35
III.1.2. Sektori për arsim.....	36
III.1.3. Sektori për financa.....	38
III.1.4. Sektori për juridik.....	38
III.2. Organet e Komunës së Bogovinës.....	39

KAPITULLI IV: STUDIMI EMPIRIK – QEVERISJA E MIRË NË FUNSKION TË MENAXHIMIT TË MIRË LOKAL, ME THEKS TË VEÇANTË NË KOMUNËN E BOGOVINËS

IV.1. Metodologjia e hulumtimit.....	45
IV.2. Grumbullimi i të dhënave.....	45
IV.3. Gjetjet dhe rezultatet në lidhje me parimin e transparencës, pjesëmarrjes dhe eficiencës.....	46
IV.4. Testimi i hipotezave.....	57

KAPITULLI VI: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Bibliografia.....	65
Shtojca.....	68

LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

Figura 1: Kontribuesit dhe funksionet e transparencës administrative.....	19
Tabela 1: Instrumentet e përdorura në faza të ndryshme të pjesëmarrjes.....	25
Tabela 2: Informimi i banorëve rreth formave të pjesëmarrjes së tyre.....	47
Tabela 3: A e dini se cili është kryetari i komunës suaj?.....	48
Tabela 4: Efikasiteti i funksionimit të komunës së Bogovinës.....	48
Tabela 5: A keni marrë pjesë deri më tani në ndonjërin nga mbledhjet e saj?.....	48
Tabela 6: A keni qenë të konsultuar rreth shqyrtimit të rregulloreve të komunës së Bogovinës?.....	49
Tabela 7: Sa jeni të motivuar të përfshihen në punët nga interesi komunal në nivel lokal?.....	49
Tabela 8: Motivi për pjesëmarrje aktive në nivel lokal.....	50
Tabela 9: A keni marrë pjesë në vendosjen e prioriteteve të komunës së Bogovinës?.....	50
Tabela 10: Si informoheni për funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës?.....	51
Tabela 11: Informacione në lidhje me funksionimin punën e Komunës së Bogovinës.....	52
Tabela 12: A janë të informuar banorët e komunës për aktivitetet dhe planet për funksionimin e komunës?.....	53
Tabela 13: A keni marrë pjesë në vendosjen e prioriteteve të komunës së Bogovinës?.....	53
Tabela 14: Si e vlerësoni efikasitetin e funksionimit të kryetarit, këshillit, anëtarëve të këshillit, administratës komunale dhe shërbimet e inspektimit komunal?.....	54
Tabela 15: Si e vlerësoni transparencën në funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës?.....	55
Tabela 16: Çfarë duhet të ndërmerret që të rritet transparenca në komunën e Bogovinës?.....	55
Tabela 17: A keni dërguar kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik deri në administratën komunale?.....	56
Tabela 18: Në cilën mënyrë do të dëshironit të merrni informacione për funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës?.....	56
Tabela 19: Cilët informacione do të dëshironit në mënyrë të detyrueshme t'i shpallni në ueb faqen e komunës?.....	57

HYRJE DHE LËNDA E HULUMTIMIT

Hyrje

“Qeverisja e mirë, me qëllime të mira është ajo që e vulos punën e qeverisë sonë. Zbatimi me integritet është pasioni ynë kryesor (Narendra Modi)”

Hulumtimi ynë, pikërisht ka të bëjë me *“qeverisjen e mirë”* - qeverisje, kjo e cila përfshin normat, traditat dhe institucionet përmes të cilave një vend ushtron autoritetin e tij mbi të mirën e përbashkët në optikën e zhvillimit.

Nga ana tjetër, përmirësimi i *“qeverisjes së mirë”* mbetet një nga sfidat kryesore të shumë vendeve në zhvillim, edhe pse vështirë dhe rrallëherë, mund të arrihet në një qeverisje e cila do të përmbush me përpikshmëri, parimet kryesore të ushtrimit të pushtetit, sikurse: transparencën, respektivisht lirinë e aksesit në dokumentacionin administrativ, lirinë e informacionit, garancinë e një drejtësie administrative si dhe motivimin e vendimeve të marra, përgjegjshmërinë si instrument që tregon nëse respektohen parimet e ligjshmërisë, transparencës, paanësisë dhe barazisë para ligjit, si dhe pjesëmarrjen apo dhënien e mundësive të të gjithë aktorëve të marrin pjesë në procesin e zhvillimit.

Së këndejmi, qeverisja e mirë ka të bëjë kryesisht me kapacitetin e qeverisë për të menaxhuar me efikasitet burimet e veta dhe për të zbatuar politika të përshtatshme, si dhe ekzistencën e një kontrolli demokratik mbi agjentët e ngarkuar nga autoriteti. Andaj, si lëndë hulumtimi kemi zgjedhur pikërisht qeverisjen e mirë, në funksion të menaxhimit të mirë, respektivisht, sa ky menaxhim i mirë ndihmon përmirësimin e cilësisë së jetës së gëzuar nga ana e të gjithë qytetarëve.

Me preardhje nga teoria mikro-ekonomike dhe shkenca administrative anglo-saksone (New Public Management), nocioni i *“qeverisjes së mirë”* është përhapur në vitet 1990 nga Banka Botërore si kusht i nevojshëm i politikave të zhvillimit. Qeverisja, sipas IT Governance Institute, ka *“për qëllim të japi orjentimin strategjik, të siguroj që objektivat janë arritur dhe që rreziqet janë menaxhuar si duhet dhe që burimet janë përdorur në mënyrë të përgjegjshme”*. Ajo

kujdeset me prioritet të respektojë interesat e atyre *“që kanë të drejta”* (qytetarët, pushtetet publike, aksionerët, etj) dhe të bëj që zërat e tyre të dëgjohen në drejtimin e punëve.

Në shoqëritë perëndimore të rregulluara nga demokracia liberale, qeverisja i referohet ndërveprimeve midis Shtetit, trupave politike dhe shoqërisë, duke përfshirë këtu edhe sistemet e lobimit dhe koalicionet e aktorëve publik dhe privat. Qeverisja e mirë synon të bëj veprimin publik më efikas dhe më të afërt për të mirën publike dhe interesin e përgjithshëm, si dhe më legjitim. Ajo synon t’i bëj shoqëritë më lehtë të qeverisshme dhe në mënyrë më të ekuilibruar, në mënyrë që ato të mos mbishfrytëzojnë burimet e veta dhe të jenë të afta t’i ripërtërijnë ato.

Komisioni Evropian ka rregjistruar nocionin e vet të qeverisjes në Librin e bardhë të qeverisjes evropiane. Kështu, shprehja qeverisja evropiane përcakton rregullat, proceset dhe sjelljet që influencojnë mbi ushtrimin e pushteteve në nivel evropian, veçanërisht në pikëpamjen e hapjes, të pjesmarrjes, të përgjegjësisë, të efikasitetit dhe të koherencës. Këto pesë *“parime të qeverisjes së mirë”* forcojnë ato të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit. Ky përcaktim është futur edhe në Traktatin e Lisbonës.

Kritikuesit e *“qeverisjes së mirë”* e shohin atë si një ideologji të mosangazhimit të Shtetit-Social, madje nje teori të dekompozimit të Shtetit, e cila ka filluar të veproj qysh prej kthesës neoliberales të viteve 1980. Ata denoncojnë abandonimin e termit *“qeveri”* dhe përdorimin e termit *“qeverisje”*, duke shpjeguar se është fjala për një demolim të pushtetit vendimmarrës të Shtetit, si garant i sovranitetit popullor, duke e zëvendësuar prej demokracisë pjesmarrëse, që nuk ka asnjë atribut realisht politik. Sipas tyre *“rrëshqitja prej qeverisë (gouvernement) në qeverisje (gouvernance)”* tregon që kalohet nga një civilizim i sovranitetit popullor të mishëruar në kushtetutat republikane, garant i interesit të përgjithshëm, në një shoqëri pragmatiste, partikulariste dhe utilitariste, garante e interesave ekonomike të veçanta, në të cilën nocioni i të mirës së përbashkët nuk ka më vend.

Me qëllim të përforcimit të qeverisjes demokratike dhe nxitjes së marrëdhënieve ndëretnike më të afërta dhe konstruktive, Misioni punon me institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore për nisma që mbështesin parimet e qeverisjes demokratike dhe vlerat e *Marrëveshjes kornizë të Ohrit*. Misioni ndihmon organet kryesore qeveritare dhe autoritetet shtetërore që t'iu përgjigjen në mënyrë më efikase sfidave të tilla si zbatimi i parimeve të përfaqësimit të barabartë, transparencë dhe llogaridhënia në administratën publike, përdorimi i gjuhëve, si dhe bartja e kompetencave dhe resurseve në nivel lokal.

Qëllimet e hulumtimit

"Me kalimin e kohës, kemi parë se vendet që kanë rritje më të mirë ekonomike janë pikërisht ato që kanë një qeverisje të mirë - qeverisje, kjo e cila vjen nga liria e komunikimit. Po ashtu, ajo vjen nga dhënia fund korrupsionit. Ajo vjen nga një popull që mund zëshëm dhe lirisht të thotë: Ky politikan është i korruptuar, ky administrator, ose ky zyrtar publik është i korruptuar (Rames Naam)."

Kjo e fundit, na bën të qartë rëndësinë dhe së këndejmi na i përcakton qëllimet e hulumtimit tonë. Punimi ynë, ka për qëllim të shkoqit mbi të gjitha efektet e qeverisjes së mirë, në funksion të menaxhimit të mirë lokal dhe implikimet në administrimin e kësaj qeverisje, pra, sa kjo qeverisje ofron transparencë, përgjegjshmëri, efiçencë dhe efektivitet, pjesëmarrje dhe si mund të administrohen në mënyrë që të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve kur jemi të vetëdijshëm për faktin se qeverisja e mirë ka implikime të ndryshme, në mënyrë që tendencat e përgjithshme të qeverisjes së mirë në funksion të menaxhimit të mirë lokal, të kenë efekte të rëndësishme - për të ofruar qëllime afatgjate, si dhe për të përmirësuar kualitetin e jetës së qytetarëve.

Siç e dimë, vetëqeverisja lokale paraqet formën e udhëheqjes së bashkësive lokale, ku banorët e saj direkt ose nëpërmjet përfaqësuesve që i zgjedhin vetë, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale. Po ashtu, vetëqeverisja lokale, pa dyshim është kategori e sistemit politik - deri diku edhe e së drejtës kushtetuese, ku njëkohësisht rëndësia e saj konsiston në faktin se, përmes vetëqeverisjes lokale rregullohen çështjet kryesore, sikurse:

- kompetencat e komunës;
- pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në marrjen e vendimeve;
- organizimi dhe puna e organeve të komunës;
- administrata komunale;
- aktet e organeve;
- prona e komunës;
- mbikëqyrja mbi punën e organeve të komunës;
- shpërndarja e këshillit të komunës;
- mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe Qeverisë së RM-së.

Pra, qeverisja e mirë në funksion të menaxhimit të mirë, synon të bëjë veprimin publik më efikas dhe më të afërt për të mirën publike dhe interesin e përgjithshëm, si dhe më legjitim. Ajo synon t'i bëjë shoqëritë më lehtë të qeverisshme dhe në mënyrë më të ekuilibruar, në mënyrë që ato të mos mbishfrytëzojnë burimet e veta dhe që të jenë të afta t'i ripërtërijnë ato.

Por, çfarë ndodh me transparencën (si tipar parësor i qeverisjes së mirë), respektivisht me publikimin e të dhënave, me informatat rreth mbajtjes së këshillit komunal, me kontakt informatat e udhëheqësve komunal, dhe sa këto indikatorë për matjen e transparencës janë të qasshme për personat e interesuar, gjegjësisht për banorët e saj; çfarë ndodh me pjesëmarrjen apo zërin e banorëve të komunës së Bogovinës, dhe sa këto të fundit janë të përfshirë në procesin e politik-bërjes dhe vendimmarrjes - pjesëmarrje, kjo e cila përfshinë numrin e referendumeve të organizuara nga ana e komunës, mbajtjen e forumeve nga ana e banorëve të komunës, konsultat paraprake me qytetarët gjatë procesit të miratimit të planeve urbanistike; çfarë ndodh me kornizat ligjore të cilat duhet të jenë të drejta dhe të zbatohet në mënyrë të paanshme; çfarë ndodh me efijencën gjatë korrelacionit të saj të drejtpërdrejtë me kapacitetet administrative, respektivisht a posedon komuna e Bogovinës revizion të brendshëm, për të vijuar me tej me cost - benefit analizën, gjegjësisht, sa kjo e fundit (komuna e Bogovinës), shfrytëzon analizën në fjalë për përcaktimin e prioriteteve, si dhe çfarë ndodh me indikatorin tjetër për matjen e efijencës, gjegjësisht me numrin e organizatave joqeveritare që janë aktive

në komunën e Bogovinës dhe që posedojnë kapacitete për mbikëqyrjen e menaxhimit financiar; çfarë ndodh me efektivitetin, respektivisht sa komuna e Bogovinës përpiqet të prodhojë rezultate që plotësojnë nevojat e banorëve të saj - rezultate, këto që prodhohen përmes përdorimit më të mirë dhe më të drejtë të burimeve të saj.

Pikërisht, këto janë pikëpyetjet ku do të përqendrohet i gjithë qëllimi i këtij hulumtimi, dhe shtylla ku do mbështetur hipoteza kryesore dhe ato ndihmëse të këtij punimi.

Hipotezat

Hipoteza kryesore:

- Qeverisja e mirë në funksion të menaxhimit të mirë lokal.

Hipotezat ndihmëse:

- Komuna e Bogovinës nuk e zbaton parimin e transparencës, për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative;
- Banorët e komunës së Bogovinës nuk janë të involvuar në procesin e politik-bërjes dhe vendimarrjes - si rrjedhojë e kulturës, traditës dhe mungesës së kapaciteteve administrative;
- Efiçenca në korrelacion të drejt për drejtë me kapacitetet administrative dhe potencën e sektorit civil të kërkoj llogaridhënie nga politik-bërsitë lokal.

Metodologjia e hulumtimit

Në përpunimin e këtij punimi hulumtues – shkencor, duke parë lëndën dhe qëllimet e hulumtimit do të përdoren metoda dhe teknika të përgjithshme dhe të veçanta shkencore me ndihmën e të cilave do të arrihet deri në përfundime konkluzive dhe rekomandime. Do të përdoret metoda e analizës, si pjesë e hulumtimit që do të bazohet në dokumente dhe raporte zyrtare, punime shkencore, artikuj të ndryshëm, ligje dhe akte ligjore, në lidhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe indikatorët kyç për matjen e të njëjtave.

Prej metodave të përgjithshme shkencore do të përdoret metoda statistikore, ku në mënyrë kuantitative do të jepen tabela dhe grafikone, rreth efijencës dhe efektivitetit, respektivisht mënyrës së menaxhimit dhe shpërndarjes së mjeteve nga ana e drejtuesve komunal.

Metodë apo teknikë tjetër që do të përdoret është intervista dhe anketat. Planifikoj që të realizoj intervistë me kryetarin e komunës së Bogovinës, dhe njëkohësisht të anketoj një numër të konsiderueshëm të banorëve, me qëllim që të nxjerrim një pasqyrë më të qartë në lidhje me efektet e qeverisjes së mirë, dhe sa këto të fundit kanë ndikuar në përmirësimin e kualitetit të jetesës së banorëve të Bogovinës.

Rëndësia e hulumtimit

Rëndësia e këtij hulumtimi konsiston në faktin se, si ushtrohet pushteti lokal - në menaxhimin e burimeve ekonomike dhe sociale, respektivisht, sa komuna e Bogovinës ka realizuar planin e saj strategjik, të prezantuar para banorëve të saj (gjatë zgjedhjeve lokale). Për më tej, sa ka arritur të sigurojë se objektivat e parashtruara janë arritur dhe se rreziqet janë menaxhuar si duhet, si dhe burimet janë përdorur në mënyrë të përgjegjshme. Pra, sa kjo e fundit (komuna e Bogovinës), është kujdesur që me prioritet të respektoj interesat e atyre “që kanë të drejta” dhe sa ka arritur komuna e Bogovinës që të mos i mbi shfrytëzojë burimet e saj, respektivisht t’i ripërtërijë ato.

Po ashtu, nëpërmjet këtij hulumtimi do të gjenerohen njohuri shtesë, të cilat priten të kontribuojnë në identifikimin e indikatorëve shtesë, për një qeverisje akoma më të mirë dhe në funksion të të gjithë qytetarëve - pavarësisht shtresave të ndryshme sociale në shoqëri.

KAPITULLI I: QEVERISJA E MIRË

I. 1. Qeverisja e mirë: definicioni, kuptimi, rëndësia

“We've seen over time that countries that have the best economic growth are those that have good governance, and good governance comes from freedom of communication. It comes from ending corruption. It comes from a populace that can go online and say, 'This politician is corrupt, this administrator, or this public official is corrupt.’” Ramez Naam

Nocioni *“Qeverisje e mirë”* është një kombinim i fjalëve *“mirë”* dhe *“qeverisje”*. Qeverisje do të thotë mënyrë e mirë për të ushtruar fuqine për të menaxhuar burimet e një organizate, prandaj qeverisja e mirë është *“Një mënyrë e mire për të ushtruar fuqine për të menaxhuar burimet e një organizate”*. Qeverisja e mirë mund të zbatohet nga sektori qeveritar, sektori privat, shoqëritë civile, individët dhe organizatat ndërkombëtare për të garantuar drejtësi, ndershmëri, efikasitet dhe efektivitet.

Koncepti i *“Qeverisjes”* nuk është i ri. Është po aq i vjeter sa vetë qeverisja. Dy nocionet *“Gouvernance”* nga fregjishtja dhe *“Gouvernement”* nga anglishtja, u përdorën për t’ju referuar akteve dhe mënyrave të qeverisjes, por nga mesi i shekullit XVI, qeverisja shënoi një *“sistem me të cilin dicka është qeverisur”*, ndërsa në fillimet e shekullit XVIII fitoi kuptimin e *“autoritetit qeverisës”*. Në këtë proces, nocioni i qeverisjes gradualist u bë i marginalizuar dhe nga shekulli XIX konsiderohej të reflektojë një arkaizëm fillestar. Për 100 vitet e ardhshme vështirë se do të përdorej si një term politik, sepse fjalorët do të definonin qeverinë në termin e autoriteteve qeverisës, duke përfshirë rendin politik dhe atë institucional, ndërkohë që qeverisja ishte trajtuar si njësi dhe proces i qeverisjes dhe zakonisht shihej si arkaike.

Megjithatë, gjatë viteve 1980, nën reformat ekonomike, nocioni i qeverisjes u bë popullor me theksin e saj në procesin dhe mënyrën e qeverisjes në konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Me rënien e Bashkimit Sovjetik dhe fundin e luftës së ftohtë termi qeverisje u përdor për të përcaktuar rishqyrtimin e administratës publike, veçanërisht për vendet në zhvillim për ti bërë më perceptues ndaj nevojave të globalizimit.

Qeverisje e mire u përdor edhe nga Presidenti i Bankës Botërore Barber Conable (1986-1991), duke iu referuar asaj si një *"shërbim publik që është efikas, një sistem gjyqësor që është i besueshëm dhe një administratë që është përgjegjëse ndaj saj"*. Koncepti i qeverisjes u zhvillua më tej në botimin e Bankës në vitin 1992 *"Governance and Development"*. Në këtë publikim, qeverisja u përkufizua si *"mënyra në të cilën ushtrohet fuqia në menaxhimin e zhvillimit ekonomik dhe sociale të një vendi"*.

Më vonë, në vitin 1994, Banka e mbështeti këtë përkufizim, *"Qeverisja është epitomizem nga parashikueshme, të hapura dhe transparente, një burokraci e mbushur me një etikë profesionale, një krah ekzekutiv i qeverisë i përgjegjshëm për veprimet e tij, dhe një shoqëri civile të fortë që merr pjesë në çështjet publike dhe të gjitha këto sillen nën sundimin e ligjit"*.

Më pas, në vitin 1998 raporti vjetor i Bankës Botërore i Qeverisjes në Azi: Nga kriza në mundësi, paraqiti një koncept më të bindshëm të qeverisjes së mirë. Raporti elaboroi katër komponentë kryesorë të qeverisjes së mirë: llogaridhënien, transparencën, parashikueshmërinë dhe pjesëmarrjen.

Duke u nisur nga përkufizimet e mësipërme, në Republikën e Maqedonisë Veriore bazat për qeverisje të mire në nivel lokal të legjislacionit Maqedonsa janë:

- **Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriore**

Sipas **(Neni 2) të kushtetutës në së Republikës së Maqedonisë Veriore**, Qytetarët e Republikës së Maqedonisë pushtetin e realizojnë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë, kurse sipas **(Neni 16)**, garantohet qasja e lire në informacione, liria e marrjes dhe bartjes të informacioneve. Për rrjedhojë, konform **(Neni 24)**, qytetarët kanë të drejtë të

parashtrojnë parashtrësia në organet shtetërore dhe shërbime tjera publike dhe për të njëjtat të marrin përgjigje, kurse sipas **(Neni 115) (Amandamenti XVII)**, qytetarët në njësitë e vetëqeverisjes lokale marrin pjesë në vendimmarrje, goftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

- **Ligji për buxhetet**

Sipas **(Neni 22)**, të ligjit për vetqeverisje lokale qarkorja buxhetore për komunat duhet të përmbajë: informata rreth treguesëve makroekonomik, përfshirë informatat për vlerësimin e të hyrave në vitin buxhetor dhe për dy vitet e ardhshëm. Po ashtu, informata rreth prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Veriore, rreth parametrave të veçantë të cilët do të përdoren për shpërndarjen e pjesës së miratuar nga të hyrat e TVSH-së së komunave, përfshirë edhe informatat për vendimet e Qeverisë për dotacionet me dsetinim, bllok dotacionet dhe dotacionet tjera të përcaktuara me ligj, si dhe vlerësimet për dotacionet në fjalë.

- **Menaxhimi me buxhetet**

Sipas **(Neni 33) të fleksibilitetit të buxheteve**, shfrytëzuesit buxhetorë, në vitin fiskal rrjedhës mund të kryejnë rishpërndarje në kuadër të buxheteve të miratuara. Pra, për shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror dhe për fondet këtë shpërndarje e miraton Minsitria për financat, kurse për komunat e miraton Këshilli i komunës.

Sipas **(Neni 34) ulja ose rritja e mjeteve** të miratuara realizohet përmes kërkesave të shfrytëzuesve buxhetor nga pushteti qendror dhe nga fondet të dërguara deri tek Ministria e financave, kurse në rastin e komunave kryetari i komunës i dorëzon kërkesë për ulje këshillit të komunës.

Sipas **(neni 36) ndryshimet dhe plotësimet e buxheteve**, vijnë në shprehje vetë nëse kryetari i komunës, vlerëson se është e nevojshme rishpërndarje më e rëndësishme e mjeteve të miratuara me buxhetin ose në rastin kur realizimi devijon nga plani, atëherë i propozon Qeverisë, respektivisht Këshillit të komunës ndryshim dhe plotësim të buxhetit.

Sipas **(neni 36)**, **Minsitri i financave më së voni deri më 31 maj** ia dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Veriore llogarinë përfundimtare të buxhetit, përfshirë edhe raportin e revizorit të autorizuar shtetëror së bashku me komentet e Ministrit të financave, si dhe llogaritë përfundimtare të buxheteve të komunave (për më shumë rreth mënyrës së financimit të komunave, sjellim në kapitullin vijues).

- **Transparenca me buxhetet**

Sipas **(Neni 53) sa i përket transparencës**, raportet për realizimin e Buxheteve të Republikës së Maqedonisë Veriore shpallen në ueb faqen e Ministrisë së financave në bazë mujore, kurse Ministri i financave më së voni deri më 31 korrik të vitit fiskal i dorëzon Qeverisë raport për realizimin e Buxhetit për gjashtë muajt e pare (përfshirë raportin e azhurnuar për treguesit makroekonomik, të hyrat e projektuara, obligimet dhe të dalat). Raporti në fjalë, shpallet në ueb faqen e Ministrisë së financave dhe përgatitet konform ligjit. Për më tej, ky i fundit dhe llogaria përfundimtare e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë shpallen në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, kurse Buxheti i komunës dhe llogaria përfundimtare e buxhetit të komunës shpallen në buletin zyrtar të komunës.

Pra, rëndësia e qeverisjes së mirë nënkupton përgjegjësi dhe transparencë në nivel lokal dhe qendror duke i inkurajuar qytetarët në procesin e vendimarrjes, të besojnë në institucionet shtetërore, të kuptojnë se mjetet nga buxheti shpenzohen në mënyrë adekuate, se me të mirat publike menaxhohet në dobi të qytetarëve, se siguria dhe privatësia e tyre janë të siguruara, e kjo çon drejt një demokracie më të fortë dhe drejt një kualiteti më të mirë jetësor. Informimi i rregullt i qytetarëve dhe inkuadrimi i tyre në konsultime dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror është një hap i rëndësishëm që e karakterizon qeverisjen e mirë.

I.2. Parimet e qeverisjes së mirë

I.2.1. Transparenca

Transparenca paraqet të drejtën e qasjes publike në informacionin kryesor. Është liria e publikut për të ditur detajet e hapave dhe masave të marra nga elementët e ndryshëm të sistemit. Sistemi është për njerëzit dhe në bazë të kësaj autoritetet publike janë të detyruar që

në mënyrë të hapur dhe profesionale të bëjnë publike të gjithë informacionin që ka të bëjë me çështjen, por gjithmonë duke qëndruar brenda kufijve të caktuar që arsyetohen nga parimet plotësuese (të dhenat personale, mbrojtja e sekretit shtetëror, etj).

Qëllimet e transparencës janë:

- Të mbrojtë interesin publik- në këtë mënyrë do të zvogëlojë mundësitë për korupsion dhe keqpërdorim
- Të mundësojë mbrojtje efikase të të drejtave individuale- duke siguruar arsyetim për vendimet e marra të administrates

Ekzistojnë mendime të ndryshme nga autorë dhe institucione të ndryshme rreth asaj se çka paraqet transparencia, sikurse në vijim:

1. Shand/ Arnberg (1996: 18 with ref. to OECD 1987) 1996, Transparency and accessibility as “components of responsive service delivery”: “Transparency - clients should know how the administration works, what the constraints on actions of public servants are, ëho is responsible for what and what remedies are available if things go wrong.” “Accessibility – clients should have easy physical access to administration at convenient hours and be offered information in plain language.”

2. Jann (1997: 96) 1997 “The central underlying theme – or even implicit ‘theory’ – of NSM is transparency.” Reichard (1998: 501) 1998 “It means that strategies and activities of a public organisation are lucid and distinct ëith regard to their goals, alternatives and effects. (...) Transparency can be seen as a dependent or as an independent variable”.

3. Pallot (2001: 646) 2001 “Transparency, or openness, is a characteristic of governance. It refers to the availability of information to the public on the transactions of the government and the transparency of decision-making process.”

4. Kondo (2002: 7) 2002 Good governance includes: “Accountability, meaning that it is possible to identify and hold public officials to account for their actions. Transparency, meaning that reliable, relevant and timely information about the activities of government is available to

the public. Openness, meaning governments that listens to citizens and business, and take their suggestions into account when designing and implementing public policies."

5. Kröger (2002: 818) 2002 *"Transparency and publicity of decision-making processes are essential for democracy."*

6. OECD (2002: 195); see also Kondo (2002: 9), Bertók et al. (2002: 43) 2002 *"Transparency – openness about policy intentions, formulations and implementation – is a key element of good governance."*


Termi *"transparencë"* nga OECD (1987: 21) ende nuk ishte përdorur, por u përfshi në një botim të mëvonshëm (OECD 1996). Në vend të kësaj, OECD përdorte termin 'kuptueshmëri', duke theksuar se administrata duhet të jetë e kuptueshme për qytetarin. Ndoshta për shkak të faktit që kjo deklaratë rrjedh nga një fazë e hershme e zhvillimit të një konceptimi të transparencës, OECD ofron një përshkrim të detajuar të karakteristikave të rëndësishme që shpesh neglizhohen, siç është vështirësia për qytetarin për të kuptuar se si vepron burokracia ose për të cilin të adresohet dhe domosdoshmëria e administratës për të thjeshtuar strukturat e saj. Për më tepër, *"sigurimi i qasjes"* (që zakonisht konsiderohet pjesë e transparencës) shihet nga një perspektivë më praktike: përmendja e barrierave që mund të pengojnë qasjen edhe nëse legjislacioni i FOI është zbatuar, siç është *"lokacioni i zyrave"* *"Lehtësira për personat me aftësi të kufizuara"* (OECD 1987: 21).

Sa i përket kësaj të fundit, kjo duket të jetë një shqetësim i pakicës - megjithatë, duke pasur parasysh zhvillimin aktual demografik në shumë vende, nevojat e një popullsie të plakur duhet gjithashtu të plotësohen dhe shpesh në mënyra të ngjashme.

Në përputhje me tre përmasat kryesore (ligji, menaxhimi publik, qeverisja), perspektiva e rolit të qytetarit ndryshonte dhe kështu bën edhe kuptimi i transparencës. Diskutimet e hershme për pjesëmarrjen u përqendruan në pyetjen se si qytetarët mund të mbrojnë më mirë interesat e tyre kundër veprimeve administrative. Prandaj, qytetari u perceptual kryesisht në rolin e një personi që është potencialisht i shqetësuar.

Në dritën e NPM, qytetari u bë një 'klient' ose 'klient' i administratës, i cili u detyrua të vepronte në mënyrë të 'orientuar nga klientët'. Së fundi, theksi u zhvendos tek qytetari si anëtar e shoqërisë civile që kërkohet të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe ofroi një bashkëpunim me administratën (HAUBNER 2001: 25; BOGUMIL 1999).

Figura 1: Kontribuesit dhe funksionet e transparencës administrative



Nga figura më sipër, shigjetat e dyfishta tregojnë se transparencja mund të jetë edhe në varësi të perspektivës. REICHARD (1998: 501) dhe MITCHELL (1998:112) nënvizojnë se transparencja mund të konsiderohet një variabël e varur ose e pavarur; fokusi i vëmendjes mund të jetë në efektet që transparencja mund të ketë ose mbi "determinantët" e saj, mbi "cilat faktorë rritin (...) transparencën" (MITCHELL 1998: 110, 112).

Procesi i paraqitur në kolonën e majtë ilustron një lidhje të mundshme mes dimensioneve të ndryshme. Në këndin e poshtëm të djathtë, konfliktet e mundshme. Efekti i transparencës në efikasitetin dhe efektivitetin administrativ është një çështje e debatueshme dhe ekzistojnë argumente për secilën pozitë (efikasiteti dhe efektiviteti avancohen për shkak të informimit më të mire për pranimin më të madh të vendimeve administrative, ose pengohen për shkak të ndërhyrjes nga jashtë dhe koha dhe shpenzimet e përfshira).

Pra, ilustrimi më sipër shërben për të treguar kontributin e kontribuesëve të mëdhenj në temën e transparencës në administratën publike.

I.2.2. Përgjegjshmëria

“Transparency without accountability becomes meaningless” Armstrong 2005

Përgjegjshmëria është një nga themelet e qeverisjes së mire. Nocioni i përgjegjshmërisë është një koncept amorf që është i vështirë për t'u definuar në terma të saktë. Në përgjithësi, përgjegjësia ekziston kur ekziston një marrëdhënie ku një individ ose një organ dhe kryerja e detyrave ose funksioneve të atij individit ose organi, i nënshtrohen mbikëqyrjes, drejtimit ose kërkesës së një personi që të japin informacion ose justifikim për veprimet e tyre. Prandaj, koncepti i llogaridhënies përfshin dy faza të ndryshme: përshtatshmërinë (ansëerability) dhe zbatimin.

Përshtatshmëria i referohet detyrimit të qeverisë, agjencive të saj dhe zyrtarëve publikë për të siguruar informacion në lidhje me vendimet dhe veprimet e tyre dhe për t'i justifikuar ato tek publiku dhe ato institucione përgjegjësie të ngarkuara me sigurimin e mbikëqyrjes, ndërsa zbatimi sugjeron që publiku ose institucioni përgjegjës për llogaridhënien mund të sanksionojë palën ofenduese ose të përmirësojë sjelljen.

Përgjegjshmëria është një virtyt etik, pasi etika shqetëson parimet dhe rregullat që qeverisin vlerën morale të sjelljes së njerëzve. Përmirësimi i etikës është thelbësor për rritjen e përgjegjshmërisë dhe anasjelltas.

Vlerat etike si integriteti, ndershmëria, paanshmëria dhe kursimi janë pjesë e vlerave të përbashkëta, të cilat udhëheqin veprimtarinë dhe performancën e sektorit publik. Praktika jo etike përbën një masë të madhe të sjelljes dhe veprimeve, të cilat përfshijnë pandershmërinë, përtacinë, neglizhencën, mosefikasitetin ose vetëkënaqësinë nga ana e zyrtarëve publikë, si dhe mashtrimin dhe korrupsionin.

Agjentët e përgjegjshmërisë nga të cilët rrjedhin marrëdhëniet e autoritetit përfshijnë mbikëqyrësit, drejtuesit e zgjedhur politik dhe ligjvënësit, gjykatat, agjencitë e auditimit të jashtëm, shoqatat profesionale, bashkëpunëtorët, klientët dhe publiku i gjerë (Romzek, 2000).

Standardet e përgjegjshmërisë kanë qenë konvencionalisht të lidhura me arritjen e progresit ekonomik shoqëror në formën e rendit dhe ligjit, zbutjen e varfërisë, gjenerimin e punësimit, mirëqenien publike; dhe ruajtjen e vlerave të tilla si integriteti, barazia, paanshmëria, përfaqësimi dhe drejtësia (Haque, 2007).

Mjetet e llogaridhënies të praktikuara tradicionalisht përfshijnë (Haque, 2000):

- mekanizmat e jashtëm-formal, duke përfshirë instrumentet legjislative (komisionet legjislative dhe shqyrtimi parlamentar), mjetet ekzekutive (kontrolli i ushtruar nga drejtuesit politikë mbi agjencitë publike) dhe proceset gjyqësore ose kuazi-gjyqësore (gjykatat administrative dhe ombudspersoni);
- mekanizmat e jashtëm-informal, grupet e interesit, sondazhet e opinionit dhe shqyrtimi i mediave;
- mekanizmat e brendshëm-formalë, duke përfshirë rregullat zyrtare, kodet e sjelljes, hierarkitë zyrtare dhe shqyrtimet e performancës; dhe,
- mekanizmat e brendshëm-joformal, siç janë kultura organizative, etika profesionale dhe presioni i bashkëmoshatarëve.

I.2.3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja e publikut do të thotë se njerëzit ose palët e interesit kanë shanse për të shprehur mendimet e tyre dhe për të marrë pjesë në aktivitetet që ndikojnë në jetën e njerëzve. Gjithashtu, mendimet e tyre merren në konsideratë gjatë marrjes së vendimeve.

Pjesëmarrja e publikut ekziston me një sistem komunikimi të hapur. Me fjalë të tjera, komunikimet ndodhin në mënyrë formale dhe joformale, duke lejuar palët e interesuara të ndajnë informacion dhe si rrjedhojë të promovojnë unitetin e publikut.

Pavarësisht nga kërkesa për angazhimin e njerëzve në procesin e qeverisjes, për një kohë shumë të gjatë, njerëzit u konsideruan thjesht marrës të shërbimeve qeveritare pa pasur ndonjë rol në formulimin e politikave, vendimmarrjes apo në zbatimin e programit. Edhe pse pjesëmarrja nganjëherë shkakton vonesa në vendimmarrje (Innes dhe Booher, 2007) ose rrit koston (Olson, 1965) ose sjell konflikt (Bureekul, 2000), shumica e kritikëve e përshkruajnë atë si një mjet për qëndrueshmërinë e programeve të zhvillimit (W. Waheduzzaman, 2010).

Shumica e shkencëtarëve (përveç Thomas, 1993, Vroom dhe Yetton, 1973), kanë përshkruar se angazhimi i njerëzve duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për të qenë një element efektiv në zbatimin e programeve. Shkencëtarë të ndryshëm social kanë rekomanduar faza të ndryshme të procesit të pjesëmarrjes së njerëzve në programet e zhvillimit lokal.

Për shembull, Arnstein (1969) përshkruan tetë faza:

- Manipulimi;
- Trajtimi;
- Informimi;
- Konsultimi;
- Plasimi;
- Partneriteti;
- Fuqia e deleguar dhe
- Kontrolli i qytetarëve.

Në të kundërt, Wilcox (1994) dhe Shoqata Ndërkombëtare për Pjesëmarrjen Publike (IAP2, 2003) propozuan pesë faza të pjesëmarrjes së njerëzve, të cilat janë:

- Informimi
- Konsultimi
- Përfshirja ose vendimi së bashku
- Bashkëpunimi ose veprimi së bashku, dhe
- Fuqizimi.

Megjithatë, në mesin e këtyre fazave të ndryshme të pjesëmarrjes, janë përzgjedhur katër fazat e mëposhtme pasi ato janë të zakonshme dhe universale.

Faza 1: Informimi - është një proces i njëanshëm, ku njerëzit janë përfituesit e thjeshtë dhe njësia është furnizuesi. Në këtë fazë, njësia qeverisëse u tregon njerëzve vendimet e tyre para ose gjatë zbatimit e programeve të zhvillimit.

Faza 2: Konsultimi - është komunikim me dy drejtime, ku njësia qeverisëse u vjen njerëzve me propozimin e tyre dhe konsulton çështjen për të marrë vendimin e zbatimit. Por, angazhimi i njerëzve zakonisht është i kufizuar brenda kohëzgjatjes së procesit të vendimmarrjes së programit. Për më tepër, njerëzit janë duke u dëgjuar nga organi i zbatimit të projektit pa pasur konfirmim se mendimi i tyre do të merret parasysh për vendimin përfundimtar. Për më tepër, njerëzit nuk kanë asnjë fushë për t'u përfshirë në të gjitha fazat e zbatimit të projektit. Organi qeverisës zakonisht informon njerëzit, në mënyrë që të marrë reagime dhe pas kësaj merr një vendim dhe zbaton programin në mënyrë të njëanshme.

Faza 3: Përfshirja - në këtë fazë njësia qeverisëse përfshin njerëzit në vendimmarrje, angazhon njerëzit me shpërndarjen e buxhetit dhe zbaton të gjithë programin së bashku. Por, në këtë nivel komuniteti/palët e interesit, si një e tërë, nuk i janë dhënë mundësitë për t'u angazhuar. Kjo është për shkak të përfshirjes fraksionale të njerëzve që mund të ndodhin në këtë lloj procesi. Në praktikë, në këtë fazë, autoriteti tenton të konsultohet vetëm me një grup të zgjedhur njerëzish dhe lejon që vetëm grupi të përfshihet në program në vend që të përfshijë të gjithë komunitetin.

Faza 4: Fuqizimi - në këtë fazë njësia qeverisëse krijon hapësirën për zhvillimin e aftësisë së njerëzve, për të dalë me vendimet dhe burimet e tyre dhe bashkërisht të vendosin për zbatimin e programeve zhvillimore.

Tabela 1: Instrumentet e përdorura në faza të ndryshme të pjesëmarrjes

Fazat e pjesëmarrjes	Robinson, 2002	Local Government Association, 2007	Bishop and Davis, 2002
Informimi	Ndërgjegjësimi, Fushatë	Posta e drejtpërdrejtë, Kolona e shtypit lokal,	Sondazhet, Fushata e informimit publik
Konsultimi	Sondazh, Seminar, Ekspozitë dhe Komente	Takimet publike, Sondazhet, Diskutimet,	Takimet e grupeve të interesit, Takimet publike, Dëgjimet publike
Përfshirja	Komiteti këshillues i komunitetit, Konsultimi i palëve të interesuara	Forumi, Fokus grupe	Këshillat e bordit, Komisionet këshilluese të qytetarëve, Forumi i komunitetit të politikave,
Fuqizimi	Forumi diskutues, Juria e qytetarëve, Referendum	Grupet këshillëdhënëse, Komitetet drejtuese	Referendum, Parlamentet e komunitetit, Votimi elektronik
<i>Burimi: Mapping Public Participation in Policy Choices, by Patrick Bishop and Glyn Davis, Institute of Public Administration, 2002</i>			

Në bazë të fazës së pjesëmarrjes së njerëzve, hulumtuesit kanë zhvilluar katër modele për të përshkruar cilësitë e qeverisjes, sikurse:

- **Modeli menaxherial** - Qasja poshtë e zbatimit, fushëveprimi i marginalizuar për pjesëmarrjen e njerëzve.
- **Modeli legjislativ** - procesi vendimmarrës i iniciuar nga lartë për të zhvilluar një agjendë të përbashkët nëpërmjet konsultimit me njerëzit.
- **Modeli i pjesëmarrjes së kufizuar të komunitetit** - bashkësia e komunitetit për të hapur procesin e vendimmarrjes që në fund krijon harmoni brenda organit drejtues dhe/ose brenda komunitetit.
- **Modeli i fuqizimit të komunitetit** - qasja që varet nga pjesëmarrja e gjerë e komunitetit (Gibson, Lacy & Dougherty 2005). Siç ka zbuluar literatura, pjesëmarrja e njerëzve është

elementi qendror i qeverisjes së mirë, kështu që nivelet e pjesëmarrjes së njerëzve lidhen me nivelin e qeverisjes.

Pra, me kuptimin dhe definicionet e ndryshme të *“Qeverisjes së mire”*, kontributin e autorëve të ndryshëm rreth qeverisjes së mire, si dhe me parimet e qeverisjes së mire përmbyllim kreun në fjalë, përtë kaluar tek Korniza juridike e vetqëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë Veriore.

KAPITULLI II: KORNIZA JURIDIKE E VETËQEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË VERIORE

II.1. Kompetencat e vetëqeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale paraqet formë të udhëheqjes së bashkësive lokale ku qytetarët në mënyrë direkt ose nëpërmjet përfaqësuesve që i zgjedhin vetë, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale një numër të punëve i kryejnë në mënyrë të pavarur (punët konkrete), një pjesë tjetër e kryejnë në pajtim me organet kompetente të pushtetit shtetëror (punët e caktuara), kurse punët e deleguara organet e pushtetit shtetëror ua besojnë organeve të pushtetit lokal. Në vazhdim, do të përmendim disa punë konkrete që njësitë e vetqeverisjes lokale mund t’i bëjnë në mënyrë të pavarur, si psh (Aliu & Stavileci, 2009):

- mund të sjellin programin për zhvillim, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare;

- programin për rregullimin e tokës për ndërtim sipas ligjit;
- t'i caktojnë zonat dhe të mbledhin taksat e tokës;
- ta rregullojnë dhe ta organizojnë ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale, lagjeve dhe objekteve të infrastrukturës me rëndësi lokale;
- të rregullojnë furnizimin me ujë të pijshëm dhe vaditje, pastrimet publike, elektrifikimin publik, pastrimin e parqeve dhe sipërfaqeve me rëndësi lokale;
- rregullimin e udhëtimit të qytetarëve, mirëmbajtjen e sinjaleve të komunikacionit;
- rregullimin e tregjeve publike dhe shfrytëzimin e tyre, mirëmbajtjen e varrezave;
- rregullimin dhe shfrytëzimin e lugut të lumenjve;
- rregullimin dhe shfrytëzimin e parkimeve;
- mund të formojnë mjete të informimit me rëndësi lokale, për krijimin e shkollave të mesme profesionale në pajtim me ligjin;
- të japin mendim me rastin e hapjes së shkollave tetëvjeçare si dhe t'i financojnë ato në nivelin që e siguron Republika;
- të japin mendime dhe propozime për zhvillimin e rrjetit dhe institucioneve kulturore, sportive, mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes së kafshëve dhe bimëve, mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit jetësor.

Vetqeverisja lokale e Republikës së Maqedonisë është materie e kushtetutës, andaj në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë përshkruhen kompetencat e komunës, respektivisht në pjesën **e III “KOMPETENCAT E KOMUNAVE”, në “LIGJIN PËR VETQEVERISJE LOKALE” Neni 20, 21, 22, 23 dhe 24**, sikurse në vijim:

Sipas **(Neni 22), të Ligjit për vetqeverisje lokale të Republikës së Maqedonisë Veriore**, Komunat janë kompetente për kryerjen e punëve vijuese:

- Planifikimi urbanistik (urban dhe rural), dhënia e lejes për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimi i hapsirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore.
- Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës - masa për mbrojtje dhe pengimin nga ndotja e ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurmimi dhe rrezatimi jonizues.

- Zhvillimi ekonomik lokal- planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal ; përcaktimi i përparësive zhvillimore dhe strukturale, udhëheqja me politikën ekonomike ; përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të iniciativave në nivel lokal dhe në atë kontekst pjesëmarrja në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal të institucioneve dhe agjensive dhe promovimi i partneritetit;
- Veprimtaritë komunale -furnizimi me ujë për pije; përcjellja e ujit teknologjik; përcjellja dhe pastrimi i ujrave të ndotura; ndriçimi publik; dërgimi dhe trajtimi i ujrave atmosferik; mirëmbajtja e higjienës publike; grumbullimi, transportimi dhe procedimi me mbeturinat e ngurta komunale; rregullimi dhe organizimi i trafikut publik lokal të udhëtarëve; furnizimi me gaz natyror dhe energji ngrohëse; mirëmbajtja e varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhënia e shërbimeve mortërore; ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale, rrugëve dhe objekteve të tjera të infrastrukturës; rregullimi i regjimit të komunikacionit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimeve rrugore të komunikacionit, ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirës publike të parkimit; mënjanimi i automjeteve të parkuara gabimisht; mënjanimi i automjeteve të dëmtuara nga sipërfaqet publike; ndërtimi dhe mirëmbajtja e tregjeve; pastrimi i oxhaqeve; mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, gjelbërimit, park-pyjeve dhe sipërfaqeve rekreative; rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i shtratit të lumenjve në pjesët e 8 urbanizuara; përcaktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës.
- Kultura - përkrahja institucionale dhe financiare të enteve dhe projekteve kulturore; kultivimi i folklorit, zakoneve, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore; organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të llojllojshme specifike të krijimtarisë.
- Sporti dhe rekreacioni - zhvillimi i sportit masiv dhe i aktiviteteve rekreative; organizimi i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive; mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve për sport; përkrahja lidhjeve sportive;
- Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve - çerdhe për fëmijë dhe shtëpi të pleqve (pronësi, financim, investime dhe mirëmbajtje); realizimi i përkujdesjes sociale për

persona invalidë; fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore; fëmijëve me probleme edukativo-sociale; fëmijëve me nevoja të veçanta; fëmijëve nga familjet njëprindërore; fëmijëve në rrugë; personave të ekspozuar rrezikut social; personave të prekur nga keqpërdorimi i drogës dhe alkoolit; ngritja e vetëdijes së popullatës; strehimi i personave të rrezikuar social; realizimi i së drejtës dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore. Kryerja e këtyre kompetencave është në pajtueshmëri me Programin Nacional për zhvillim të mbrojtjes sociale;

- Arsimi - themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror, në pajtueshmëri me ligjin, organizimi i transportit dhe ushqimit të nxënësve dhe vendosjen e tyre në konvikte nxënësish;
- Mbrojtja shëndetësore - të drejtuarit me rrjetin e organizatave publike shëndetsore dhe me objektet nga mbrojtja shëndetësore primare të cilët duhet ta përfshijnë përfaqsimin e vetëqeverisjes lokale në të gjitha këshillat të të gjitha organizatave në pronësi publike, edukata shëndetësore; përparimi i shëndetit; aktivitete preventive; mbrojtja e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtja gjatë punës; mbikqyrja shëndetësore mbi mjedisin jetësor; mbikqyrja mbi sëmundjet ngjitëse; ndihmë pacientëve me nevoja speciale (për shembull, shëndeti mental, keqpërdorimi i fëmijëve etj.) dhe lëmenj të tjerë që do të përcaktohen me ligj;
- Zbatimi i përgatitjeve dhe ndërmarrrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe nga pasojat e shkaktuara nga to.
- Mbrojtja kundër zjarrit që kryejnë njësitet territoriale kundër zjarrit;
- Mbikqyrja mbi kryerjen e punëve nga kompetenca e sajë;
- Punë të tjera të përcaktuara me ligj.
- Kompetencat nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhen në përputhje me standardet dhe procedurat e caktuara me ligj.
- Me ligj përcaktohen punët në kompetencë të komunës të cilat ajo është e detyruar t'i kryej.

II.2. Korniza juridike mbi parimin e qeverisjes së mire

Qeverisja e mirë nuk ka të bëj me marrjen e vendimeve "**korrekte**", por ka të bëj me procesin më të mirë të mundshëm për marrjen e këtyre vendimeve. Po ashtu, qeverisja e mirë nuk është e lidhur vetëm me performancën e institucioneve, por edhe me kontributin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e marrjes dhe zbatimit të vendimeve.

Duke u nisur nga kjo, në vijim sjellim aktet ligjore kyçe të cilat drejtpërsëdrejti **e përkufizojnë kornizën institucionale** në të cilën funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes lokale, përfshirë pjesët që u referohen bazave të qeverisjes, respektivisht llogaridhënies, procesit të përkufizimit buxhetor dhe strukturës së dokumenteve buxhetore, kompetencave, etj. Për rrjedhojë, **përkufizimit i kornizës ligjore dhe institucionale** sipas së cilës operojnë komunat fillon me ligjet për buxhetet dhe mënyrën e realizimit të tyre, ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, ligjin për kontrollin e brendshëm financiar public dhe për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Mirëpo, se çka siguron secili nga ligjet në fjalë për qytetarët e Republikës së Maqedonisë Veriore, i sjellim në pjesë vijuese:

- **Ligji për buxhetet i shpallur në „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 64/2005, 04/2008, 103/2008, 156/2009, 95/10, 180/11, 171/12, dhe 192/15**, rregullon procedurat për përgatitjen, miratimin, qeverisjen dhe realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë Veriore si edhe të buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale (komunat) dhe të qytetit të Shkupit.
- **Ligji për vetëqeverisjen lokale** për here të pare është nxjerrë në vitin 1953 dhe shënon një hap të rëndësishëm për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale, pasi që në mënyrë të detajuar rregullon vetqeverisjen lokale në Republikën e Maqedonisë. Mirëpo, me ndryshimet e mëvonshme, **ligji për vetëqeverisje lokale i shpallur në „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 5 nga 29.01.2002**, rregullon: kompetencat e komunës; pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në marrjen e vendimeve; organizimin dhe punën e organeve të komunës; administratën komunale; aktet e organeve, pronën - pronësinë e komunës; mbikëqyrjen mbi punën e organeve të

komunës; shpërbërjen e këshillit të komunës; mekanizmat e bashkëpunimit midis komunave dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Veriore; vetëqeverisjen vendore; mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale; përcaktimin e gjuhëve zyrtare në komuna dhe çështje tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.

- ***Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale i shpallu në „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“numër 61/2004, 96/2004, 67/2007, 156/2009 dhe 47/11, 192/15***, rregullon financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, respektivisht përcaktimin e mënyrës së arkëtimit të të hyrave të komunave dhe ngarkimin e komunave me borxh, përfshirë edhe buxhetin e komunave. Pra me këtë ligj rregullohet përmbajtja, miratimi, menaxhimi, raportimi, evidenca e kontabilitetit, kontrolli dhe revizionin.
- ***Ligji për kontrollin e brendshëm financiar publik i shpallur në „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“numër 90/09, 12/11, 188/13, 192/15***, rregullon sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik në Republikën e Maqedonisë, respektivisht menaxhimi financiar dhe kontrollin, revizionin e brendshëm dhe harmonizimin e tyre.
- ***Ligji mbi kontabilitetin për buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetorë i shpallur në „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 61/2002, 98/2002, 82/2005, 24/11 dhe 145/15***, rregullon mbajtjen e kontabilitetit, librave afaristë, dokumenteve të kontabilitetit dhe përpunimin e të dhënave, njohjen e të hyrave dhe të dalave, vlerësimin e pozitave të bilancit, revalorizimin, raportet financiare, dorëzimin e raporteve financiare dhe çështje tjera në lidhje me kontabilitetin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale (komunat).
- ***Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik i shpallur në „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“numër 13/2006, 86/2008, 6/10, 42/14 dhe 148/15*** rregullon të drejtat e qytatarëve për qasje në informacione, respektivisht mënyrat dhe procedurat për realizmin e së drejtës së qasjes së lirë në informacione me karakter publik. Po ashtu, me këtë ligj sigurohet publicitet dhe transparencë në punën e

poseduesve të informacioneve, dhe u mundëson personave fizikë dhe juridikë ta realizojnë të drejtën e qasjes së lirë në informacione me karakter publik.

II.3. Mënyrat e financimit të vetëqeverisjes lokale

Për të patur një organizim dhe funksionim të mirëfilltë të organeve të pushtetit lokal, rëndësi të veçantë duhet kushtuar financimit të njësive të vetëqeverisjes lokale. Sipas **(Neni 3 dhe 4) të Ligjit për financim të vetëqeverisjes lokale**, financimi i vetëqeverisjes lokale realizohet përmes dy burimeve kryesore, edhe atë:

- **Nga të ardhurat burimore të caktuara me ligj, sikurse:**
 - Tatimet (një pjesë nga tatim fitimi, tatimi i pasurive të lëna në trashëgim dhe dhuratave të pasurive të pa tundshme);
 - Taksat e tokës komunale, taksat komunale dhe të ardhurat nga shërbimet;
 - Të ardhurat nga pasuritë e veta
 - Të ardhurat tatimore republikane ose nga jashtë (në mall ose para)
 - Fitime nga ndërmarrjet dhe shërbimet publike të formuara nga njësia e vetëqeverisjes lokale;
 - Të ardhurat nga gjobat për mosrespektimin e rregullave të njësisë së vetëqeverisjes lokale;
 - Të ardhurat tjera të parapara me ligj.
- **Nga të ardhurat prej mjeteve plotësuese të buxhetit të Republikës së Maqedonisë Veriore, si dhe të ardhurat në formë të huasë nga buxheti i Republikës**, që të mos ndërpritet funksionimi i njësive të vetëqeverisjes lokale. Gjatë kësaj periudhe ndihme të madhe kanë dhënë organizata ndërkombëtare PHARE, USAID, etj.

Mirëpo, problematika e financimit të njësive lokale të vetëqeverisjes lokale trajtohet edhe *me Kushtetutën e vitit 1991*, si dhe me *Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale të vitit 1995, në (Neni 11)*, sikurse në vijim:

- Në përputhje me politikën ekonomike të shtetit, komuna financohet nga burime të veta të të ardhurave dhe nga burime të tjera të financimit.
- Burime personale të të ardhurave të komunës janë tatimet lokale, kompensimet dhe taksat.
- Komuna në suaza të përcaktuara me ligj, e përcakton lartësinë e shkallës së tatimeve dhe lartësinë e kompensimeve dhe taksave nga paragrafi (2) i këtij neni.
- Komuna financohet edhe nga dotacionet e shtetit dhe burimeve të tjera të të ardhurave.
- Komuna ka të drejtë të hyj në borxh në tregun e brendshëm dhe të jashtëm të kapitalit, në përputhje me ligjin.
- Komuna, në suaza të kompetencave të veta, disponon në mënyrë të pavarur me burimet e veta të të ardhurave.
- Burimet e të ardhurave të komunës duhet të sigurojnë kryerje përkatëse të kompetencave të saja të përcaktuara me ligj. (8) Financimi i komunës rregullohet me ligj.

Për rrjedhojë, buxheti i Komunës përbëhet prej pjesës së përgjithshme, veçantë dhe asaj zhvëllimore (Memeti & Trenovski, 2017).

Pjesa e përgjithshme përfshinë: bilancin e konsoliduar të të hyrave dhe të dalave, klasifikimin funksional të të dalave, bilancin e të të hyrave dhe të dalave operativo-rrjedhëse, si dhe bilancin e të hyrave dhe të dalave kapitale. Kurse, **pjesa e veçantë** shpreh të dalat sipas klasifikimit të të dalave të cilin e përcakton Ministri i financave, të grupuara sipas shfrytëzuesve dhe programeve, përfshirë edhe arsyetim të buxhetit.

Për më tej, *në procesin buxhetor në (Neni 27) të Ligjit për financim të vetëqeverisjes lokale,*
kemi:

- Ministri i financave më së voni deri më 30 shtator të vitit rrjedhës përgatit qarkore buxhetore për vitin e ardhshëm. „
- Me qarkoren buxhetore komunat lajmërohen për treguesit makroekonomikë themelorë, kahjet kryesore për përgatitjen e buxhetit komunal, dotacionet për komunat që do të transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e fondeve, si edhe nga të hyrat nga burimet e tjera. „
- Në qarkoren buxhetore përcaktohet forma dhe përmbajtja e buxhetit komunal.
- Afatet për planifikimin e buxhetit komunal rregullohen me kalendarin buxhetor të miratuar nga Këshilli i komunës. „
- Këshilli i komunës e miraton buxhetin për vitin e ardhshëm më vonë deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës, sipas llogarive, sipas programeve dhe sipas pikave/paragrafëve.
- Me kalendarin buxhetor përcaktohen afatet në të cilat:
 - Kryetari deri tek shfrytëzuesit buxhetor i paraqet udhëzimet kryesore për përgatitjen e planeve financiare;
 - Shfrytëzuesit buxhetor komunal i dorëzojnë planet e tyre financiare deri tek kryetari, dhe
 - Kryetari i komunës e paraqet propozim buxhetin deri tek Këshilli i komunës

Pra, me trajtimin e Kornizës juridike të vetqeverisjes lokale e përmbyllim kreun në fjalë, për të kaluar me “Qeverisjen e mire”, në funksion të menaxhimit të mire local në rastin e Komunës së Bogovinës.

KAPITULLI III: KOMUNA E BOGOVINËS DHE ORGANIZIMI I SAJ (KËNDVËSHTRIMI)

Komuna e Bogovinës është komunë shqiptare që shtrihet në Rajonin e Pollogut të pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë Veriore. Qendra e komunës ndodhet në fshatin Bogovinë, sipas të cilës mban emrin edhe Komuna. Kjo komunë kufizohet në veri me Komunën e Tetovës, në lindje me Komunën e Bërvenicës, në jug me Komunën e Vrapçishtit dhe në perëndim me Republikën e Kosovës.

Komuna e Bogovinës ka një shtrirje fushore me një lartësi mbidetare prej 550 metrash. Nga qendra e Tetovës Bogovina është larg afërsisht 12 kilometra. Ngastra e saj përfshin një sipërfaqe prej 11 km². Në të mbizotëron një tokë e punueshme, me një sipërfaqe prej 838,4 hektarë, kullotave u takojnë 39,8 hektarë, ndërsa pyjeve 99,1 hektarë. Po ashtu, Komuna e Bogovines i përfshin këto vendbanime: Fshatin Pallcisht, Sedllarcë, Jelovjan, Kamijan, Sinican, Novak, Novo Selo, Pirok, Rakovec, Selc, Urvic dhe Zherovjan.

Sipas regjistrimit të vitit 2002 në Komunën e Bogovines jetojnë 28,997 banorë nga të cilet, shqiptarë 27,614 (95.2%), turq 1,183 (4.1%), maqedonas 37 (0.1%) dhe 163 (0.6%) janë të etnive të tjera.

III.1. Mënyra e organizimit

III.1.1. Sektori për urbanizimi

Vetëqeverisja lokale që i kyen punët në pajtim me organet kompetente të administratës janë:

- Përgatitja e programit për përpunimin e planeve urbanistike - planifikim urbanistik (plan urbanistik për fshat, plan urbanistik jashtë vendbanimit, aktet e përgjithshme dhe dokumentacione planore të tjera me interes lokal), përpunimi, ndjekja, implementimi i procedurës për sjelljen e planeve urbanistike;
- Dhënia e lejes për ndërtim për ndërtesat me interes lokal të përcaktuara me ligj;
- Përcaktimi i statusit të objekteve të ndërtuara pa leje të përcaktuara me ligj;
- Rregullimi i hapësirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore;
- Sigurimi i kushteve për furnizim me ujë për pije;
- Mirëmbajtje, rekonstruim dhe ndërtim të rrugëve lokale, rrugicave dhe trotuareve;
- Përcaktimi i emrave të rrugëve dhe objekteve tjera infrastrukturore;
- Komunikacioni dhe sinjalizim i komunikacionit: krijimi i kushteve për vendosjen e infrastrukturës së nevojshme nëpër vendbanime;
- Mbrojtja e qytetarëve dhe të mirave materiale dhe menaxhimi me krizat;
- Përgatitja e projekteve;
- Punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe rregullore të tjera, statut edhe akte të Kryetarit dhe Këshillit të Komunës.

III.1.2. Sektori për arsim

Duke qenë se arsimi është njëri nga segmentet kryesorë në përditshmërinë e njerëzve, në Korrik të vitit 2005, Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore solli vendimin se vetëqeverisja lokale do të jetë kompetente për masat dhe aktivitetet në sferën e arsimit, respektivisht në themelimin, financimin dhe administrimin e shkollave të mesme dhe fillore në bashkëpunim me pushtetin qendror, si dhe në organizimin e transportit dhe ushqimit të nxënësve.

Menaxhimi i shkollave bëhet nga ana e Bordeve shkollore, ndërsa udhëheqja nga ana e drejtorëve të shkollave. Drejtori i shkollës fillore dhe të mesme zgjidhet dhe shkarkohet nga ana e kryetarit të komunës konform Ligjit. Mirëpo, gjatë zgjidhjes së drejtorit të një shkolle fillore apo të mesme, kryetari i komunës është i kufizuar sepse Bordi Shkollor sipas Ligjit i propozon vetëm një kandidat për emërim. Kryetari duhet që ta emëron kandidatin e propozuar për drejtor. Nëse kryetari nuk dakordohet me zgjidhjen e kandidatit të propozuar atëherë ai e kthen lëndën përsëri në rishqyrtim te Bordi Shkollor i cili ka për detyrë që të bën propozim të ri.

Në shkollat fillore të cilat kanë më shumë se 24 paralele, Bordi shkollor numëron 9 anëtarë, edhe atë:

- tre përfaqësues nga arsimtarët, bashkëpunëtorët profesional dhe edukatorët, të zgjedhur nga ana e këshillit të arsimtarëve të shkollës;
- tre përfaqësues nga prindërit, gjegjësisht, tutorët e nxënësve, të cilët i zgjedh këshilli i prindërve;
- dy përfaqësues nga komuna të zgjedhur nga ana e këshillit komunal;
- një përfaqësues nga Ministria e arsimit i emëruar nga ana e Ministrisë së arsimit.

Në shkollat fillore të cilat kanë më pak se 24 paralele Bordi shkollor numëron 7 anëtarë, edhe atë:

- dy përfaqësues nga arsimtarët, bashkëpunuesit profesional dhe edukatorë;
- dy përfaqësues nga prindërit, gjegjësisht tutorët e nxënësve;
- dy përfaqësues nga komuna;
- një përfaqësues nga Ministria e arsimit.

Në shkollat e mesme Bordi shkollor numëron 12 anëtarë, edhe atë:

- Katër përfaqësues nga profesorët;

- Tre përfaqësues nga prindërit apo tutorët;
- Tre përfaqësues nga komuna;
- Nga një përfaqësues i Ministrisë së arsimit dhe bashkësisë afariste.

Përfaqësuesit e profesorëve zgjidhen në Bordet e shkollave, nga ana e këshillit mësimor-shkencor në bazë të propozimit dhe shumicës së votave, përfaqësuesit e prindërve zgjidhen nga ana e këshillit të prindërve, ndërsa përfaqësuesit e komunave zgjidhen nga ana e këshillave komunal.

Financimi i shkollave të mesme dhe fillore bëhet në dy mënyra për grupe të ndryshme komunash:

- Bllok dotacioneve: për komunat të cilat kanë hyrë në fazën e dytë të implementimit të decentralizimit;
- Dotacioneve të dedikuara: për komunat tjera, të cilat ende janë në fazën e parë të implementimit të decentralizimit.

III.1.3. Sektori për financa

Sektori për financa është njeri nga sektorët më të rëndësishëm, sepse pa financim nuk mund të kemi organizim dhe funksionim të mirfilltë të organeve të pushtetit lokal.

Detyrat esenciale të këtij sektori janë:

- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit;
- Analizat e realizimit dhe planifikimit buxhetor;
- Tatimet dhe realizimi i të hyrave vetanake;
- Furnizimet publike;
- Shërbimet e kontabilitetit të institucionit;

- Përgatitja e raporteve financiare;
- Zhvillimi ekonomik lokal;

III.1.4. Sektori juridik

Sektori për punë juridike dhe punë të përgjithshme administrative i kryen këto punë:

- Përgatitjen e seancave të këshillit dhe seancave të komisioneve të tij;
- Përgatitjen e vendimeve dhe akteve tjera të përgjithshme dhe të veçanta nga kompetenca e këshillit dhe kryetarit;
- Jep mendim për aktet nga aspekti i ligjshmërisë së tyre, i ndjek dispozitat, ndryshimet dhe plotësimet e tyre;
- Kryen punë profesionale dhe organizative për këshillin dhe kryetarin e komunës;
- Punë për dhënien ndihmë dhe intervenime të nevojshme juridike në sektorët dhe njësitë tjera të administratës komunale.
- Përgatitjen për mbrojtje civile, bashkësitë lokale, punës zyrtare që e përfshin pranimin, hapjen, evidentimin dhe dërgimin e akteve të organeve të komunës, punë lidhur me parkun e vozitjes, punë të tjera ndihmëse teknike.
- Kryerjen e punëve që kanë të bëjnë me informimin e qytetarëve për realizimin më të lehtë të të drejtave të tyre ;
- Punë organizativo- administrative për këshillin dhe kryetarin e komunës;
- Vepron me dokumentet e komunës dhe i ruan deri në zhdukjen e tyre, përkatësisht dorëzimin e tyre në arkivin shtetëror të Republikës së Maqedonisë.

3.2. Organet e Komunës së Bogovinës

Organet e Komunës së Bogovinës sipas ligjit të vetëqeverisjes lokale janë:

- Këshilli

- Kryetari
- Organet drejtuese dhe administrative

1. Këshilli i Komunës së Bogovinës

Është organ përfaqësues si cili përbëhet prej një grupi të caktuar këshilltarësh, të caktuar në raport me numrin e popullsisë së cdo njësie të paraparë me statutin e njësisë. Këshilli formon grupe të përkoshme dhe të përhershme në njësi ku jetojn shumica e konsiderueshme e nacionaliteteve. Komisioni formohet për çdo nacionalitet që të jetë i përfaqësuar në njësinë e vet lokale. Zgjidhet me vota të fshehta nga përfaqësuesit e zgjedhur në zgjedhjet e lokaleve të lira. Varësisht nga numri i popullsisë, caktohet edhe numri i anëtarëve të këshillit, ku në Komunën e Bogovinës, numri i anëtarëve të këshillit është 19 (numri i anëtarëve të Këshillit Komunal nuk mund të jetë më i vogël se 11 dhe më i madh se 31).

Organizimi dhe puna e Këshillit të komunës së Bogovinës është e rregulluar në bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, pjesa **V. ORGANIZIMI DHE PUNA E ORGANEVE TË KOMUNËS, Neni 31- 56**. Në bazë të këtyre neneve kuptojmë se këshilli si organ përfaqësues i qytetarëve vendos në suaza të kompetencave të komunës ndërsa për shqyrtimin e çështjeve dhe përcaktimin e propozimeve, këshilli formon komisione të përhershme dhe të përkohshme.

Për më tej, zgjedhja e anëtarëve të këshillit rregullohet me ligj. Këshillin e përbëjnë përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Kurse, numri i anëtarëve të Këshillit përcaktohet varësisht nga numri i banorëve në komunë.

Në tabelën e mëposhtme është i shprehur numri i anëtarëve të Këshillit, në raport me numrin e banorëve të një vendi. Numri i anëtarëve të Këshillit nuk mund të jetë më pak se 9 anëtarë e as më shumë se 33 anëtarë. Në komunën e Bogovinës, numri i anëtarëve të Këshillit është 19 anëtarë.

Sipas **(Neni 34) të Ligjit për vetëqeverisje lokale**, sjellim numrin e anëtarëve të Këshillit Konform numrit të banorëve, sikurse:

Banorë	Anëtarë të Këshillit
deri 5000	9
prej 5001 deri 10.000	11
prej 10.001 deri 20.000	15
prej 20.001 deri 40.000	19
prej 40.001 deri 60.000	23
prej 60.001 deri 80.000	27
prej 80.001 deri 100.000	31
mbi 100.000	33

Anëtarët e këshillit zgjidhen me mandat katërvjeçar. Ata përfaqësojnë qytetarët dhe në Këshill vendosin sipas bindjeve të tyre. Në punën e këshillit dhe në komisionet e tij, anëtarët e komisionit kanë të drejtë dhe obligim të jenë prezent, në seancat e këshillit të japin iniciativa dhe propozime dhe t'i parashtrojnë pyetje prefektit, ndërsa për mendimin e shfaqur ose për votimin në këshill anëtari i këshillit nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose të arrestohet.

Kompetencat e Këshillit të komunave sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale të Republikës së Maqedonisë Veriore, janë:

- Sjell statutin e komunës dhe dispozita të tjera;
- Sjell buxhetin dhe llogarinë vjetore të komunës;
- Përcakton shumën e burimeve personale të të ardhurave të financimt të komunës, në suaza të përcaktuara me ligj;
- Themelon veprimtari publike në suaza të kompetencave të komunës dhe bënë mbikqyrjen mbi punën e tyre;
- Emëron anëtarë të këshillave drejtues të veprimtarive publike të cilat i themelon;

- Sjell programe për punë dhe plane financiare për financim të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna;
- I miraton raportet për realizimin e buxhetit dhe llogarinë vjetore të komunës;
- Vendos për dhënien e lejeve për kryerje të veprimtarisë të interesit publik me rëndësi lokale në përputhje me ligjin;
- I miraton raportet për punën e veprimtarive publike që i ka themeluar komuna;
- Vendos për mënyrën e disponimit me pronën e komunës.
- Vendos mbi mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës në përputhje me ligjin.
- Zgjedh personin që udhëheq me njësinë rajonale të ministrisë për punë të brendshme në komunë, në përputhje me ligjin;
- Shqyrton dhe miraton raportin vjetor për sigurinë publike në territorin e komunës, të cilin e dorëzon deri te ministri i punëve të brendshme dhe avokati popullor;
- Mund t'i jep rekomandime personit udhëheqës të njësisë rajonale të ministrisë për punë të brendshme nga fusha e sigurisë publike dhe sigurisë në komunikacion dhe
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Zgjedhja e kryetarit të këshillit kryhet nga përbërja e anëtarëve të këshillit, ku në bazë të votimit zgjedhet kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit, me mandat katërvjeçar. Nëse në rrethin e parë asnjëri nga kandidatët për kryetar nuk ka fituar numër të mjaftueshëm të votave, kalohet në rrethin e dytë të votimeve për dy kandidatët që në rrethin e parë kanë fituar më shumë vota dhe si përfundim ai i cili në rrethin e dytë fiton më shumë vota, zgjedhet kryetar i Këshillit.

Me marrjen e mandatit, kryetar i këshillit ka këto obligime, edhe atë:

- të udhëheq seancat e këshillit;

- të kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit dhe
- të nënshkruaj dispozitat që i ka sjellur këshilli dhe t'i ja dorëzon prefektit për publikim (në afat prej tre ditësh nga dita e sjelljes).

2. Kryetari i Komunës së Bogovinës

Kryetari i komunës zgjidhet çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithëshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë në përputhje me ligjin me të cilin rregullohen zgjedhjet lokale. Detyra e tij fillon menjëherë pas dorëzimit të mandatit të prefektit të mëparshëm, në afat prej shtatë ditësh nga dita e zgjedhjeve. Në periudhën e ushtrimit të detyrës, kryetar nuk duhet të kryejë detyra tjera profesionale, ndërsa në raste mungese ose pengese, prefekti cakton se cili nga anëtarët e këshillit do ta zëvendësojë atë (përvec kryetarit të Këshillit). Ndërprejra e parakohëshme e mandatit të kryetarit ndodh në rast vdekjeje, dorëheqjeje, nëse me vendim të plotëfuqishëm është i dënuar për vepër penale me dënim me burg në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj, nëse me vendim të plotëfuqishëm i merret e drejta e aftësisë për punë, nëse paraqitet gjendja e papërputhshmërisë për kryerjen e funksionit në pajtim me Ligjin për zgjedhje locale dhe në rast të mungesës të paarsyeshme më gjatë se gjashtë muaj.

Sipas **(Neni 50), të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë Veriore** kompetencat e kryetarit të komunës janë:

- E përfaqson dhe prezanton komunën
- E kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të këshillit;
- I shpall dispozitat e këshillit në gazetën zyrtare të komunës;
- E siguron zbatimin e vendimeve të këshillit;
- E siguron kryerjen e punëve të cilat me ligj i janë deleguar komunës;
- Inicon dhe propozon sjelljen e dispozitave nga kompetencat e këshillit;

- E propozon buxhetin vjetor të komunës dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës.
- E realizon buxhetin e komunës;
- Zgjedh drejtorë të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna, në bazë të konkursit publik.
- Rregullisht e njofton këshillin për kryerjen e kompetencave të veta në përputhje me statutin;
- Vendos në punë administrave për të drejtat, obligimet dhe intereset e personave juridik dhe fizik, në përputhje me ligjin.
- Sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale;
- Udhëheq me administratën komunale;
- Vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën e komunës, nëse ndryshe nuk është e përcaktuar me ligj;
- Siguron shfrytëzim të drejtë dhe ligjor, mirëmbajtje dhe mbrojtje të pronës së komunës, në përputhje me ligjin dhe statutin; dhe 16.Kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin.

3. Organet drejtuese dhe administrative

Administrata komunale si organ i komunës formohet për kryerjen e punëve në kompetencë të organeve komunale. Është e ndarë në sektorë dhe njësi dhe përbëjnë njerëz të punësuar profesional, në pajtim me ligjet që janë në fuqi në Republikën e Maqedonisë Veriore. Numri më i madh i të punësuarve në komunë kanë statusin e nëpunësve shtetëror, që garanton drejtat e tyre, por njëkohësisht i përshkruan edhe përgjegjësitë e tyre, sistemin e përparimit dhe vlerësimit.

Disa nga obligimet e administratës komunale janë:

- Kryen punët që ja cakton këshilli dhe kryetari I komunës
- Përgatit aktet për këshillin dhe prefektin, seancat e këshillit dhe seancat e komisioneve të tij;
- Kryen detyra profesionale për këshillin dhe prefektin e komunës dhe mban kontabilitetin e komunës;
- Ndjek problematikën e lëmenjve në kompetencë të komunës, kryen analizë për gjendjen dhe jep iniciativa dhe propozime për zgjidhjen e tyre, ndërsa në lidhje me aktivitetet e komunës jep të dhëna dhe informata (me kërkesë të organeve kompetente ose në bazë të ligjit).

Pra, duke marrë për Komunën e Bogovinës në kreun vijues sjellim analizën empirike nga qeverisja e mirë në funksion të menaxhimit të mire lokal.

KAPITULLI IV: STUDIMI EMPIRIK: QEVERISJA E MIRË NË FUNKSION TË MENAXHIMIT TË MIRË LOKAL- ME THEKS TË VECANTË NË KOMUNËN E BOGOVINËS

IV.1. Metodologjia e hulumtimit

Pas shqyrtimit të literaturës në lidhje me rëndësinë e “Qeverisjes së mirë” në funksion të menaxhimit të mirë lokal, me theks të veçantë në komunën e Bogovinës, dhe sa ky menaxhim i mirë ndihmon përmirësimin e cilësisë së jetës së gëzuar nga ana e banorëve, dizajnuam një pyetësor për të nxjerrë në pah rolin dhe impaktin e “qeverisjes së mirë”, në drejtim të përmbushjes së parimit të transparencës, pjesëmarrjes dhe efijencës.

IV.2. Grumbullimi i të dhënave

Dizajnimi i pyetësorit dhe njëherit testimi i tij u realizua kryesisht me banorët e komunës së Bogovinës, respektivisht me shfrytëzuesit e shërbimeve të Komunës në fjalë. Sipas regjistrimit të vitit 2002 në komunën e Bogovinës jetojnë 28,997 banorë nga të cilet, shqiptarë 27,614 (95.2%), turq 1,183 (4.1%), maqedonas 37 (0.1%) dhe 163 (0.6%) janë të etnive të tjera.

Pyetësori përfshiu gjithsej 18 pyetje, të cilat mbuluan kryesisht çështjet e transparencës, pjesëmarrjes, efijencës dhe edikasetit të funksionimit të komunës së Bogovinës.

Poashtu, pyetësorët u shpërndan në formë të rastësishme. Mostra e paraparë, për këtë studim ishte gjithsej 500 banorë, ku morëm përgjigje vetëm nga 450 banorë, përgjigjet e të cilëve u përpunuan me programin softuerik SPSS për Windows dhe Microsoft Office për Windows (Word dhe Excel) që gjen përdorim në krijimin e raporteve të ndryshme, grafikoneve dhe tabelave.

IV.3. Gjetjet dhe rezultatet në lidhje me parimin e transparencës, pjesëmarrjes dhe efijencës

Duke marrë parasysh kredibilitetin e përgjigjeve të marra nga ana e banorëve dhe vënien në funksion të programin softuerik SPSS, në vijim prezantojmë rezultatet që do të mbështesin ose hudhin poshtë hipotezën kryesore dhe ato ndihmëse të ngritura në fillim të studimit, sikurse:

Hipoteza kryesore:

- Qeverisja e mirë në funksion të menaxhimit të mirë lokal.

Hipotezat ndihmëse:

- Komuna e Bogovinës nuk e zbaton parimin e transparencës, për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative;
- Banorët e komunës së Bogovinës nuk janë të involvuar në procesin e politik-bërjes dhe vendimarrjes - si rrjedhojë e kulturës, traditës dhe mungesës së kapaciteteve administrative;
- Efiçenca në korrelacion të drejt për drejtë me kapacitetet administrative dhe potencën e sektorit civil të kërkoj llogaridhënie nga politik-bërsitë lokal.

Përpara së të kalojmë te prezantimi i përgjigjeve për secilën pyetje në veçanti, sjellim një pasqyrë të aspektit demografik.

STRUKTURA DEMOGRAFIKE E TË ANKETUARVE**• Gjinia**

<i>Gjinia</i>	
Femra	Meshkuj
50.3%	49.7%

• Mosha

<i>Mosha pjesëmarrëse</i>					
18-24 vjeç	25-34 vjeç	35-44 vjeç	45-54 vjeç	55-64 vjeç	Mbi 65 vjeç
13.7%	19.9%	18.4%	17.8%	15.1%	15.0%

• Niveli i arsimimit

<i>Niveli i arsimimit</i>

Bazik	Mesëm	Sipëror
21%	58%	21%

- **Përkatësia etnike**

<i>Përkatësia etnike</i>		
Shqipëtarë	Maqedon	Të tjerë
64.9%	24.6%	10.5%

Sa i përket sondazhit të realizuar, në vijim prezantojmë pyetjet dhe rezultatet nga të njëjtat.

INFORMIMI I BANORËVE RRETH FORMAVE TË PJESËMARRJES SË TYRE

- **Informimi i banorëve rreth formave të pjesëmarrjes së tyre**

Pyetja e parë i referohet informimit të banorëve rreth formave të pjesëmarrjes së tyre, ku me ç'rast konstatojmë se:

<i>Tabela 2: Informimi i banorëve rreth formave të pjesëmarrjes së tyre</i>	
54%	Po
46%	Jo
1%	Refuzojnë të përgjigjen

Në bazë të rezultateve të gjeneruara konstatojmë se, 54% e banorëve që morën pjesë në studim thonë se janë të njohur me format e pjesëmarrjes së tyre që përfshijnë një referendum, mbledhjen e banorëve, nismat e tyre, etj, 46% e tyre nuk janë të informuar aspak dhe vetëm 1% e tyre refuzuan të përgjigjen.

- **A e dini se cili është kryetari i komunës suaj?**

<i>Tabela 3: A e dini se cili është kryetari i komunës suaj?</i>	
58%	Po
40%	Jo
2%	Refuzojnë të përgjigjen

Rezultatet më sipër tregojnë se 58% e banorëve të komunës së Bogovinës kanë dijeni rreth asaj se, cili është kryetari i komunës së Bogovinës, 40% e tyre kanë rezultuar se nuk e dinë dhe vetëm 2% kanë refuzuar të përgjigjen.

- **Efikasiteti i funksionimit të komunës së Bogovinës**

<i>Tabela 4: Efikasiteti i funksionimit të komunës së Bogovinës</i>	
8%	Shumë efikas
31%	Pjesërisht efikas
18%	Pjesërisht joefikas
14%	Plotësisht joefikas
27%	Nuk e dinë
2%	Refuzojnë të përgjigjen

Sa i përket efikasitetit të funksionimit të komunës së Bogovinës 39% e banorëve të saj ndajnë bindjen se, komuna në fjalë funksionon në mënyrë efikase, respektivisht 8% mendojnë se operon në mënyrë shumë efikase dhe 31% e tyre pjesërisht efikase. Për më tej, 32% mendojnë se funksionimi është joefikas, gjegjësisht 18% e konsiderojnë si pjesërisht joefikase dhe 14% plotësisht joefikase. Pjesa e mbetur prej 27% nuk kanë njohuri rreth funksionimit të saj, dhe 2% refuzuan të përgjigjen.

- **A keni marrë pjesë deri më tani në ndonjërin nga mbledhjet e saj...?**

<i>Tabela 5: A keni marrë pjesë deri më tani në ndonjërin nga mbledhjet e saj...?</i>		
95%	Po	Kanë marrë pjesë në Këshillin e komunës
5%	Jo	
80%	Po	Kanë marrë pjesë në mbledhjen e banorëve
20%	Jo	
87%	Po	Kanë marrë pjesë në Referendumin e organizuar nga komuna
13%	Jo	
92%	Po	Kanë paraqitur një procedure ose propozim në komunë
8%	Jo	

Pyetja e katërt i referohet pjesëmarrjes së banorëve në mbledhjet e komunës, ku rezultatet e gjeneruara tregojnë se 95% e tyre kanë marrë pjesë në Këshillin e komunës së Bogovinës dhe 5% nuk kanë qenë pjesë e saj. Kurse, nëse kanë marrë pjesë në mbledhjen e banorëve, konstatohet se vetëm 80% e tyre kanë qenë pjesë e mbledhjeve të banorëve dhe 20% nuk kanë

marrë pjese. Sa i përket pjesëmarrjes në Referendum rezultatet tregojnë se 87% e tyre kanë marrë pjese dhe 13% nuk kanë qenë pjesë e saj. Për më tej, lidhur me paraqitjen e ndonjë procedure apo propozimi në komunë rezultatet konstatojnë se, 92% e tyre kanë paraqitur procedurë ose propozim dhe vetëm 8% e tyre nuk kanë paraqitur asnjë procedurë ose propozim.

- **A keni qenë të konsultuar rreth shqyrtimit të rregulloreve të komunës së Bogovinës?**

<i>Tabela 6: A keni qenë të konsultuar rreth shqyrtimit të rregulloreve të komunës së Bogovinës?</i>	
6%	Po
93%	Jo
1%	Refuzojnë të përgjigjen

Lidhur me pyetjen mësipër rezultatet tregojnë se, 93% e banorëve të komunës së Bogovinës nuk kanë qenë të konsultuar paraprakisht rreth shqyrtimit të rregulloreve të komunës, 6% e tyre kanë qenë të konsultuar, dhe vetëm 1% e pjesëmarrësve në sondazh refuzuan të përgjigjen.

- **Sa jeni të motivuar të përfshiheni në punët nga interesi komunal në nivel lokal?**

<i>Tabela 7: Sa jeni të motivuar të përfshiheni në punët nga interesi komunal në nivel lokal?</i>	
7%	Plotësisht të motivuar
17%	Të motivuar
27%	Po thujse jo të motivuar
41%	Plotësisht jo të motivuar
4%	Nuk e dinë
4%	Refuzojnë të përgjigjen

Referuar pyetjes se, sa banorët janë të motivuar që të përfshihen në punët nga interesi komunal në nivel lokal, rezultatet tregojnë se 24% e banorëve janë të motivuar, respektivisht 7% e tyre ndjehen plotësisht të motivuar dhe 17% të motivuar. Kurse, 68 e tyre janë të pa motivuar, gjegjësisht 27% po thujse jo të motivuar dhe 41% e tyre plotësisht të pa motivuar. Pjesa e mbetur prej 8%, gjegjësisht 4% u përkasin banorëve që nuk e dinë dhe 4% atyre që refuzojnë të përgjigjen.

- **Motivimi për pjesëmarrje aktive në nivel lokal**

<i>Tabela 8: Motivi për pjesëmarrje aktive në nivel lokal</i>		
17%	Plotësisht i motivuar	Arsim të lartë
29%	I motivuar	
26%	Përafërsisht i pa motivuar	
23%	Plotësisht i pa motivuar	
3%	Refuzojnë të përgjigjen	
2%	Nuk e dinë	
7%	Plotësisht i motivuar	Arsim i mesëm
15%	I motivuar	
28%	Përafërsisht i pa motivuar	
39%	Plotësisht i pa motivuar	
5%	Refuzojnë të përgjigjen	
6%	Nuk e dinë	
1%	Plotësisht i motivuar	Arsim fillor
9%	I motivuar	
22%	Përafërsisht i pa motivuar	
36%	Plotësisht i pa motivuar	
3%	Refuzojnë të përgjigjen	
3%	Nuk e dinë	

Tabela mësipër prezanton interesimin për pjesëmarrjen aktive në nivel lokal, respektivisht sa janë të motivuar banorët të kyçen në komunë në nivel lokal. Shifrat tregojnë se pjesa më e madhe e banorëve, gjegjësisht 39% e tyre me arsim të mesëm janë plotësisht të pamotivuar, 36% me arsim fillor dhe 23% me arsim të lartë.

- **A keni marrë pjesë në vendosjen e prioriteteve të komunës së Bogovinës?**

<i>Tabela 9: A keni marrë pjesë në vendosjen e prioriteteve të komunës së Bogovinës?</i>	
4%	Po
94%	Jo
1%	Refuzojnë të përgjigjen
1%	Nuk e dinë

Të dhënat e prezantuara tregojnë se 94% e tyre nuk kanë qenë të përfshirë në një iniciativë të tillë nga ana e komunës së Bogovinës, 4% e tyre kanë marrë pjesë, 1% e tyre refuzuan të përgjigjen dhe pjesa e mbetur nuk e dinë, gjegjësisht nuk kanë informacion të tillë.

INFORMIM RRETH FUNKSIONIMIT (PUNËS) TË KOMUNËS SË BOGOVINËS

Një pjesë e mirë e të anketuarve, respektivisht 36% e tyre janë të informuar rreth funksionimit të komunës përmes mediave tradicionale, kurse 21% përmes ueb faqes së komunës. Disa banorë rreth funksionimit të komunës së Bogovinës informohen përmes debateve publike dhe tubimeve me miqtë e afërt, që do të thotë se të paktën janë të informuar.

- **Si informoheni për funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës? (pyetje me më shumë mundësi përgjigjeje)**

Tabela 10: Si informoheni për funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës?

35.5%	Nga mediumet lokale
20.7%	Nga ueb faqja e komunës së Bogovinës
11.4%	Nga mbledhjet dhe debatet publike
9.7%	Nga kushërinjtë, familjarët dhe shokët
9.1%	Nga shtypi lokal
7.6%	Nga njoftimi i komunës së Bogovinës
6.9%	Nga buletini i lagjes/komunitetit
5.2%	Nga buletini i komunës
4.8%	Nga buletini i shtypur i komunës së Bogovinës
2.5%	Nga facebook-u
2.8%	Tjera
30.1%	Nuk kam interesim

Sipas të dhënave të prezantuara më sipër konstaktojmë se, pjesa më e madhe e tyre informohen prej formave të ndryshme të informimit, ku pjesëmarrje më të madhe zënë mediumet lokale me 35.5%, për të vijuar me ueb faqen e komunës së Bogovinës me 20.7%, nga mbledhjet dhe debatet publike me 9.7%, nga shtypi lokal, etj.

- **Informacione në lidhje me funksionimin punën e Komunës së Bogovinës (pyetje me më shumë mundësi përgjigjeje)**

<i>Tabela 11: Informacione në lidhje me funksionimin punën e Komunës së Bogovinës</i>		
37%	Nga mediumet lokale	Shqipëtarë
3%	Nga ueb faqja e komunës së Bogovinës	
10%	Nga mbledhjet dhe debatet publike	
7%	Nga kushërinjtë, familjarët dhe shokët	
18%	Nga shtypi lokal	
14%	Nga buletini i komunës	
24	Nuk kam interesim	
35%	Nga mediumet lokale	Maqedon
27%	Nga ueb faqja e komunës së Bogovinës	
12%	Nga mbledhjet dhe debatet publike	
8%	Nga kushërinjtë, familjarët dhe shokët	
7%	Nga shtypi lokal	
6%	Nga buletini i komunës	
31%	Nuk kam interesim	
35%	Nga mediumet lokale	Të tjera
21%	Nga ueb faqja e komunës së Bogovinës	
10%	Nga mbledhjet dhe debatet publike	
5%	Nga kushërinjtë, familjarët dhe shokët	
2%	Nga shtypi lokal	
2%	Nga buletini i komunës	
38%	Nuk kam interesim	

Tabela më sipër prezanton informimin e banorëve sipas përkatësisë etnike. Pra, në rastin e shqipëtarëve, maqedonëve por edhe tek banorët me përkatësi tjetër është konstatuar se informimi rreth funksionimit të komunës së Bogovinës bëhet më së shumti përmes medimeve lokale, mbledhjet dhe debatet publike, ueb faqja e komunës, nga shtypi lokal, gjë kjo që konsiston edhe me rezultatet e pyetjes paraprake.

- **A janë të informuar banorët e komunës për aktivitetet dhe planet për funksionimin e komunës?**

<i>Tabela 12: A janë të informuar banorët e komunës për aktivitetet dhe planet për funksionimin e komunës?</i>		
3%	Plotësisht pajtohem	22%
18%	Pajtohem	
33%	As pajtohem, as edhe nuk pajtohem	33%
22%	Nuk pajtohem	37%
15%	Aspak nuk pajtohem	

8%	Nuk e dinë	8%
1%	Refuzojnë të përgjigjen	1%

Pyetja më sipër i referohet faktit se, sa banorët janë të informuar me aktivitetet dhe planet për funksionimin e komunës së Bogovinës, ku me ç’rast konstatojmë se: 37% e tyre aspak nuk pajtohen, 22% plotësisht pajtohen me këtë fakt, 33 % e tyre as pajtohen, e as nuk pajtohen me këtë fakt, kurse 8% nuk e dine dhe vetë 1% refuzuan të përgjigjen.

- **A ka nevojë për organizimin e zyrave të Komunës së Bogovinës?**

<i>Tabela 13: A keni marrë pjesë në vendosjen e prioriteteve të komunës së Bogovinës?</i>		
52%	Po	
34%	Jo	
1%	Refuzojnë të përgjigjen	
13%	Nuk e dinë	

Sipas të rezultateve të gjeneruara konstatojmë se, 52% e banorëve të Komunës ndajnë bindjen se duhet të bëhet organizim i zyrave, 34% e tyre nuk e shikojnë si të arsyeshme, kurse 13% e tyre nuk e dinë dhe vetëm 1% e tyre refuzojnë të përgjigjen.

EFIKASITETI NË FUNSKIONIMIN E KOMUNËS SË BOGOVINËS

Në vijim prezantojmë ërgjigjet e grumbulluara të të anketuarve në lidhje me efikasitetin në punën e kryetarit, këshillit, administratës dhe shërbimeve të inspektimit komunal.

- **Si e vlerësoni efikasitetin e funksionimit të kryetarit, këshillit, anëtarëve të këshillit, administratës komunale dhe shërbimet e inspektimit komunal?**

<i>Tabela 14: Si e vlerësoni efikasitetin e funksionimit të kryetarit, këshillit, anëtarëve të këshillit, administratës komunale dhe shërbimet e inspektimit komunal?</i>		
18%	Plotësisht efikas	Kryetari
35%	Pjesërisht efikas	
19%	Pjesërisht joefikas	
19%	Plotësisht joefikas	
10%	Nuk e dinë	
15%	Plotësisht efikas	Këshilli, anëtarët e këshillit

29%	Pjesërisht efikas	
20%	Pjesërisht joefikas	
20%	Plotësisht joefikas	
17%	Nuk e dinë	
15%	Plotësisht efikas	Administrata komunale
29%	Pjesërisht efikas	
22%	Pjesërisht joefikas	
20%	Plotësisht joefikas	
15%	Nuk e dinë	Shërbimet e inspektimit komunal
13%	Plotësisht efikas	
26%	Pjesërisht efikas	
21%	Pjesërisht joefikas	
21%	Plotësisht joefikas	
18%	Nuk e dinë	

Sipas të dhënave të prezantuara më sipër në lidhje me vlerësimin e efikasitetit konstatojmë se, kryetari i komunës ka përqindjen më të lartë të përgjigjeve pozitive edhe atë me 53%, e ndjekur nga Këshilli dhe administrata komunale, ndërsa për shërbimet e inspektimit komunal 39% mendojnë se punojnë në mënyrë efikase në krahasim me 43% që mendojnë se këto shërbime nuk funksionojnë në mënyrë efikase. 19% e të anketuarve ishin të pa informuar për punën e shërbimeve të inspektimit në komunën e Bogovinës.

TRANSPARENCA NË FUNKSIONIMIN (PUNËN) E KOMUNËS SË BOGOVINËS

Në lidhje me vlerësimin e transparencës në funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës, të anketuarit kishin një qëndrim të presrë. Rezultatet e përgjigjeve sjellim në vijim:

- **Si e vlerësoni transparencën në funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës?**

10%	Shumë transparent	43%
33%	Pjesërisht transparent	
23%	Pjesërisht jo transparent	44%
21%	Plotësisht jo transparent	
13%	Nuk e dinë	13%

Të dhënat e gjeneruara nga tabela 14 tregojnë se, 43% e banorëve ndajnë bindjen se egziston shumë transparencë sa i përket funksionimit (punës) së komunës së Bogovinës,

ndërkohë që pjesa tjetër prej 44% kanë qëndrim të kundërt me transparencën në lidhje me funksionimin e komunës së Bogovinës. Vetëm një pjesë prej 13% nuk kanë dhënë ndonjë vlerësim sa i përket transparencës gjatë funksionimit të komunës së Bogovinës.

- **Çfarë duhet të ndërmerret që të rritet transparenca në komunën e Bogovinës?**

<i>Tabela 16: Çfarë duhet të ndërmerret që të rritet transparenca në komunën e Bogovinës?</i>	
70%	Takime më të shpeshta me banorët
41%	Shpallja e të gjitha informacioneve në ueb faqen e komunës së Bogovinës
25%	Shpallja në gazetën komunale
20%	Komunikim elektronik me komunën
3%	Të duket puna e bërë dhe jo të mbetet vetëm në letër
2%	Të ketë informacione dhe njoftim në mediat komunale
2%	Të punojnë më mirë
3%	Tjerë
3%	Nuk e dinë

Në lidhje me masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e transparencës, 70% e banorëve mendojnë se takimet më të shpeshta me banorët e komunës së Bogovinës do të çojnë drejt rritjes së transparencës, e ndjekur më tej nga shpallja e informacioneve në ueb faqe (41%), shpallja në gazetën komunale (25%), komunikimi elektronik (20%), etj.

INFORMACIONET NGA KARAKTERI PUBLIK

Pjesa më e madhe e të anketuarve që ishin pjesë e sondazhit në fjalë, deri më tani nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik në administratën komunale. Në vijim prezantojmë rezultatet e të anketuarve.

- **A keni dërguar kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik deri në administratën komunale?**

<i>Tabela 17: A keni dërguar kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik deri në administratën komunale?</i>	
5%	Po
92%	Jo
3%	Refuzojnë të përgjigjen

Rezultatet e gjeneruara në lidhje me pyetjen paraprake tregojnë se, 5% e të anketuarëve kanë dërguar kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik deri në

administratën komunale, 92% e tyre nuk kanë ndërmarrë ndonjë iniciativë të tillë, dhe pjesa 3% u përket të anketuarëve që nuk kanë informacion në lidhje me një mundësi të tillë.

- **Në cilën mënyrë do të dëshironit të merrni informacione për funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës? (pyetje me mundësi me më shumë përgjigje)**

50%	Nga ueb faqja e komunës
50%	Nga buletini i komunës
12%	Nga mediumet lokale
3%	Nga mbledhjet e drejtpërdrejta
4%	Të tjera
2%	Nuk kam interesim
1%	Refuzojnë të përgjigjen
12%	Nuk e dinë

Sa i përket përcaktimit se cilën nga metodat do të dëshironin t'i merrnin informacionet e karakterit publik, 50% e të anketuarve janë përcaktuar për ueb faqen e komunës, 50% nga buletini i komunës, 12% e tyre prej mediave locale, 3% nga mbledhjet e drejtpërdrejta, etj.

INFORMACIONE RRETH UEB FAQES SË KOMUNËS SË BOGOVINËS

Pjesa më e madhe e të anketuarve, respektivisht rreth dy e treta e banorëve pajtohen që informacionet që janë të detyrueshme të shpallen në ueb faqen e komunës janë informacionet lidhur me projektet e implementuara nga ana e komunës së Bogovinës. Po ashtu, informacionet mbi shërbimin, buxhetin, raportet e ndryshme financiare përkojnë me pjesën tjetër të të anketuarve.

- **Cilët informacione do të dëshironit në mënyrë të detyrueshme t'i shpallni në ueb faqen e komunës? (pyetje me mundësi me më shumë përgjigje)**

68%	Informacione për projektet që implementohen nga komuna e Bogovinës
53%	Informacione shërbyese
50%	Buxheti dhe raportet financiare
49%	Informacione për të gjitha shërbimet që komuna i siguron nga shabllonat e kërkuara
33%	Informacione mbi ndërmarrjet në pronësi publike dhe ndërmarrjet e krijuara
11%	Nuk e dinë

Pyetja e fundit e pyetësorit ka të bëj me atë se, cilët lloje të informacioneve dëshirojnë banorët që në mënyrë të detyrueshme t'i shpall komuna e Bogovinës në ueb faqen e saj, ku me ç'rast 68% e të anketuarve vlerësojnë se në ueb faqe duhet të shpallen informacionet lidhur me projektet e implementuara nga ana e komunës së Bogovinës, 53% e tyre informacionet shërbyese, 50% informacionet lidhur me buxhetin dhe raportet financiare, 49% mbi shërbimet që komuna e Bogovinës i siguron, për mos anashkaluar informacionet mbi ndërmarrjet në pronësi publike dhe ndërmarrjet e krijuara (49%) dhe 11% e tyre nuk kanë informacion rreth kësaj të fundit.

IV.4. Testimi i hipotezave

Pra, duke marrë për bazë faktin e qeverisjes së mirë në funksionin të mirë të menaxhimit lokal, ngritëm edhe hipotezën kryesore dhe ato ndihmëse për ta mbështetur studimin në fjalë. Mirëpo, se sa këto hipoteza mbështesin studimin tonë, në tabelat vijuese sjellim edhe testimin e tyre:

Testimi i hipotezës kryesore	Pranojmë ose hedhim poshtë (për testimin e hipotezës kryesore shërbehemi me rezultatet nga ekzaminimi i secilit parim të qeverisjes së mirë)
<ul style="list-style-type: none"> Qeverisja e mirë në funksion të menaxhimit të mirë lokal. 	Edhe rezultatet e gjeneruara nga përgjigjet e të anketuarve në lidhje me parimet kryesore të qeverisjes së mire (transparenca, pjesëmarrja, përgjegjësia, llogaridhënia), na bëjnë me dije se fokusi kryesor duhet të jetë përmirësimi i transparencës, pjesëmarrjes së banorëve në vendimarrje, në llogaridhënie përmes informimit të qytetarëve për implementimin e projekteve të realizuara, andaj edhe hipoteza kryesore: <i>qeverisja e mirë në funksion të menaxhimit të mirë lokal, është e pranueshme.</i>

Për mbështetjen e hipotezës kryesore kemi ngritur gjithsej 3 hipoteza ndihmëse të cilat i testojmë përmes rezultateve të gjeneruara nga pyetësori.

Testimi i hipotezave ndihmëse	Pranojmë ose hedhim poshtë (për testimin e hipotezave ndihmëse shërbehemi me rezultatet e
-------------------------------	---

	gjeneruara nga të anketuarit në Komunën e Bogovinës)
<ul style="list-style-type: none"> Komuna e Bogovinës nuk e zbaton parimin e transparencës, për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative. 	<p>Gjatë ekzaminimit të parimit të transparencës dhe sa të anketuarit vlerësojnë se Komuna e Bogovinës është transparente në marrjen e vendimeve, implementimin e projekteve, konstatuam se:</p> <ul style="list-style-type: none"> 43% e të anketuarve vlerësojnë se Komuna e Bogovinës është transparente sa i përket funksionimit (punës) së saj; 44% kanë qëndrim të kundërt me transparencën në lidhje me funksionimin e komunës së Bogovinës; 13% e tyre nuk kanë treguar asnjë vlerësim sa i përket transparencës. <p>Pra, sa i përket hipotezës së pare ndihmëse se: <i>komuna e Bogovinës nuk e zbaton parimin e transparencës, për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative, konstatojmë se është e pranueshme.</i></p>
<ul style="list-style-type: none"> Banorët e komunës së Bogovinës nuk janë të involvuar në procesin e politik-bërjes dhe vendimarrjes - si rrjedhojë e kulturës, traditës dhe mungesës së kapaciteteve administrative. 	<p>Gjatë ekzaminimit se sa banorët e komunës së Bogovinës janë të involvuar në mbledhjet e komunës së Bogovinës, konstatuam se:</p> <ul style="list-style-type: none"> 95% e tyre kanë qenë pjesë në Këshillin e komunës së Bogovinës; 5% nuk kanë qenë pjesë e këshillit; 80% e tyre kanë qenë pjesë e mbledhjeve të banorëve; 20% nuk kanë marrë pjesë; 87% e tyre kanë marrë pjesë në Referendum; 13% nuk kanë qenë pjesë e Referendumit; 92% e tyre kanë paraqitur procedurë ose propozim; 8% e tyre nuk kanë paraqitur asnjë procedurë ose propozim; <p>Sa i përket vendosjes së prioriteteve në Komunën e Bogovinës, konstatuam se:</p> <ul style="list-style-type: none"> 4% kanë marrë pjesë; 94% e tyre nuk kanë marrë pjesë në vendosjen e prioriteteve; 1% refuzuan të përgjigjen; 1% nuk ishin të informuar;

	<p>Lidhur me atë se sa banorët kanë qenë të konsultuar rreth ndryshimit të rregulloreve të komunës së Bogovinës, konstatojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 6% kanë qenë të konsultuar; • 93% e tyre aspak s'kanë qenë të konsultuar; • 1% e tyre refuzuan të përgjigjen. <p>Pra, në bazë të rezultateve të gjeneruara nga rastet paraprake, vijmë në përfundim se: banorët e komunës së Bogovinës nuk janë të involvuar në procesin e politik-bërjes dhe vendimtarjes - si rrjedhojë e kulturës, traditës dhe mungesës së kapaciteteve administrative, anda si hipotezë është e pranueshme.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Efiçenca në korrelacion të drejt për drejtë me kapacitetet administrative dhe potencën e sektorit civil të kërkoj llogaridhënie nga politik-bërsitë lokal. 	<p>Gjatë ekzaminimit se sa banorët e komunës së Bogovinës për aktivitete dhe planet e funksionimit, konstatojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 22% e tyre pajtohen se janë të informuar; • 33% e tyre edhe pajtohen edhe jo; • 37% aspak nuk pajtohen; • 8% nuk kanë informacion; • 1% refuzojnë të përgjigjen. <p>Duke u bazuar në përgjigjet në fjalë konstatohet se: banorët duhet të kërkojnë llogaridhënie nga sektori lokaj rreth realizimit të programeve të promovuara, implementimit të projekteve, andaj hipoteza ndihmëse e fundit: efiçenca në korrelacion të drejt për drejtë me kapacitetet administrative dhe potencën e sektorit civil të kërkoj llogaridhënie nga politik-bërsitë lokal është e pranueshme.</p>

KAPITULLI V: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzionet që dalin nga ky studim do t'i sistemoj si në vijim:

- Si rrjedhojë e procesit të decentralizimit po konstatohet se, njësitë e vetëqeverisjes lokale u ballafaquan me nivel shumë të ulët të organizimit dhe menaxhimit të administratës komunale, mungesë të pajisjeve, si dhe me cilësi të ulët të burimeve njerëzore.

- Mungesa e kapaciteteve adekuate administrative për të apsorbuar dhe realizuar punët në ingerenca të pushteti lokal është shumë e shprehur tek numri i njësive rurale të vetëqeverisjes lokale.
- Mungesa e kapacitetit të resurseve njerëzore parasegjithash është rezultat i mungesës së shkathtësive dhe njohurive nga kultura organizative burokratike e bazuar në parimin lartë-poshtë në raport me qytetarët.
- Mos sanksionimi për mos përmbushjen e parimeve të administrimit bashkëkohor (efiçienca, efektiviteti, cilësia, evaluimi) nga kaudri ligjor, sjell në qeverisje “jo të mirë” te pushtetit lokal që më së miri u vërtetua edhe nga përgjigjet e qytetarëve.
- 54% e banorëve që morën janë të njohur me format e pjesëmarrjes së tyre (referendum, mbledhje e banorëve, nismat etj) dhe 46% e tyre nuk janë të informuar.
- 58% e banorëve të komunës së Bogovinës kanë dijeni se cili është kryetari i komunës së Bogovinës, kurse 40% e tyre nuk e dinin se cili është kryetari i komunës së Bogovinës.
- 39% e banorëve të komunës së Bogovinës ndajnë bindjen se, komuna funksionon në mënyrë efikase, 32% mendojnë se funksionimi është joefikas, 27% nuk kanë njohuri rreth funksionimit të saj, dhe 2% refuzuan të përgjigjen.
- 95% e banorëve të anketuar kanë marrë pjesë në Këshillin e komunës së Bogovinës, 80% kanë qenë pjese e mbledhjeve të banorëve, 87% kanë marrë pjesë në Referendum dhe 92% e tyre kanë paraqitur procedurë ose propozim në Komunën e Bogovinës.

- 93% e banorëve të anketuar nuk kanë qenë të konsultuar për shqyrtim të rregulloreve të komunës, 6% kanë qenë të konsultuar, dhe 1% e tyre refuzuan të përgjigjen.
- 24% e banorëve janë të motivuar të përfshihen në punët nga interesi komunal në nivel lokal, 68 e tyre nuk janë të motivuar, 4% nuk kanë informacion rreth përfshirjes së tillë dhe 4% refuzuan të përgjigjen.
- 39% e banorëve me arsim të mesëm janë plotësisht të pamotivuar në përfshirjen e punëve nga interesi komunal në nivel lokal, 36% me arsim fillor dhe 23% e tyre me arsim të lartë.
- 94% e të anketuarve nuk kanë qenë të përfshirë në vendosjen e prioriteteve të komunës së Bogovinës, 4% e tyre kanë qenë të përfshirë, 1% nuk kishin informacion dhe 1% refuzuan të përgjigjen.
- 35.5% e banorëve të të anketuar rreth funksionimit të komunës së Bogovinës informohen nga mediumet lokale, 20.7% nga ueb faqja e komunës, 20.7% nga mbledhjet dhe debatet publike dhe 9.7% nga shtypi lokal.
- 37% e të anketuarve aspak nuk janë të informuar me aktivitetet dhe planet për funksionimin e komunës së Bogovinës, 22% e tyre janë të informuar, 8% nuk kanë dijeni rreth kësaj të fundit dhe 1% refuzuan të përgjigjen.
- 52% e banorëve të Komunës së Bogovinës mendojnë se duhet bërë organizim i zurave kurse 34% e tyre e vlerësojnë si të pa arsyeshme një iniciativë të tillë.

- 53% e banorëve e vlerësojnë me efikasitet të lartë punën e kryetarit të komunës së Bogovinës, 53% e vlerësojnë Këshillin dhe administratën komunale dhe 39% e tyre i vlerësuan shërbimet e inspektimit komunal me efikasitet të lartë.
- 43% e banorëve ndajnë bindjen se funksionimi i komunës së Bogovinës është shumë transparente, 44% kanë qëndrim të kundërt me transparencën dhe vetëm 13% nuk kanë dhënë ndonjë vlerësim sa i përket transparencës gjatë funksionimit të komunës së Bogovinës.
- 70 % e banorëve mendojnë se takimet më të shpeshta me banorët e komunës së Bogovinës do e rrisin transparencën, 41% mendojnë se nga shpallja e informacioneve në ueb faqe do rritet transparenca, 25% mendojnë se nga shpallja në gazetën komunale dhe vetëm 20% e banorëve të anketuar vlerësojnë se nga komunikimi elektronik do të rritet transparenca sa i përket funksionimit të komunës së Bogovinës.
- 5% e të anketuarëve kanë dërguar kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik deri në administratën komunale, 92% e tyre nuk kanë dërguar, dhe 3% e tyre nuk kanë informacion në lidhje me një mundësi të tillë.
- 50% e të anketuarve kanë zgjedhur ueb faqen e komunës për marjen e informacioneve me karakter publik, 50% buletin e komunës, 12% e tyre mediat lokale dhe 3% nga mbledhjet e drejtpërdrejta.
- 68% e të anketuarve ndajnë bindjen se në ueb faqe duhet të shpallen informacionet lidhur me projektet e implementuara, 53% mendojnë se duhet të shpallen informacionet shërbyese, 50% informacionet lidhur me buxhetin dhe raportet

financiare, 49% mbi shërbimet që komuna e Bogovinës i siguron, 49% informacionet mbi ndërmarrjet në pronësi publike dhe ndërmarrjet e krijuara dhe 11% e tyre nuk kanë informacion rreth kësaj të fundit.

Rekomandimet që dalin nga ky studim do t'i sistemoj si në vijim:

1. Sigurim i një platforme bashkëpunimi mes njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe banorëve të komunës së Bogovinës, që do përfshij:
 - një grup punues dhe i cili do të trajtoj çështjen e pjesëmarrjes së banorëve të komunës së Bogovinës;
 - inkorporimin e mekanizmave online në ueb faqen e komunës së Bogovinës, si dhe;
 - krijimin e një ueb portali që do t'ju mundësojnë shpalljen online të çdo instrumenti për pjesëmarrje të banorëve të komunës së Bogovinës.

 2. Të sigurohet një mbështetje për udhëheqësit administrativ përmes programeve të trajnimit me qëllim të ngritjes së vetëdijes së tyre, në drejtim të informimit dhe pjesëmarrjes aktive.

 3. Hartimi i rregulloreve apo udhëzimeve të brendshme që në mënyrë të detajuar do të përshkruajnë procedurat për qasje në informata, konsultime dhe pjesëmarrje aktive të banorëve të komunës së Bogovinës.
- Forcimi i bashkëpunimit mes pushtetit lokal dhe organizatave donator në drejtim të ngritjes së kapaciteteve dhe stabilitetit të organizatave të shoqërisë civile, si një urë lidhëse mes qytetarëve dhe pushtetit lokal, përmes ndërmarrjes së veprimeve vijuese, sikurse:
 - krijimin e portaleve për komunikim;

- hartimin e një sistemi të unifikuar për aplikimin e kriterëve gjatë ndarjes së mjeteve buxhetorë;
- aplikimi me projekte për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve komunale dhe mbrojtjen e interesave të banorëve të komunës së Bogovinës;
- organizimi dhe realizimi i trajnimeve të përbashkëta rreth asaj se, si duhet hartuar dhe aplikuar një propozim projekti përpara donatorëve të huaj;

5. Rritja e bashkëpunimit mes komunës së Bogovinës dhe medimeve lokale përmes nënshkrimit të memorandumeve për bashkëpunim me mediumet lokale, publikimin e çdo mekanizmi formal në më së paku në një mjet të informimit dhe në gjuhën që flasin shumica e banorëve, si dhe nxitjen e përdorimit në maksimum të rrjeteve sociale nga ana e administratës së komunës së Bogovinës.

6. Nxitja e pjesëmarrjes së banorëve të komunës së Bogovinës në mbledhjet e Këshillit Komunal të komunës së Bogovinës, përmes sigurimit të kushteve fizike për pjesëmarrje të tillë, si dhe të transmetohen dhe arkivohen video inçizime nga mbledhjet e Këshillit në ueb faqen e komunës së Bogovinës.

7. Shqyrtimi dhe krijimi i mundësive për ofrimin e shërbimeve në vendbanimet që për distancë fizike e kanë të vështirë komunikimin me administratën e komunës së Bogovinës. Kjo e fundit mund të arrihet përmes themelimit të zyrave të disperzuara për komunikim, ku çdo banorë do të ketë në qasje në formularët, broshurat e publikuara nga ana e komunës së Bogovinës, ku njëherit këto zyrat do të shërbejnë edhe si mundësi për sigurimin e informacioneve kthyesë rreth vështirësive me të cilat ballafaqohen banorët e komunës së Bogovinës.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

- Barbara S. Romzek, "**Dynamics of public sector accountability in an era of reform**", International Review of Administrative Sciences, March 2000.
https://www.researchgate.net/publication/249689122_Dynamics_of_Public_Sector_Accountability_in_an_Era_of_Reform
- M. Shamsul Haque "**Significance of Accountability under the New Approach to Public Governance**", Sage Journals, December 1, 2000.
<https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/0020852300664004>
- M. Shamsul Haque, "**Limits of public accountability under the reinvented state in developing nations**", *Public Administration Quarterly*, Vol. 31, No. 3/4, 2007.
<https://www.jstor.org/stable/41288298?seq=1>
- W. Waheduzzaman, "**Value of people's participation for good governance in developing countries**" Transforming Government People Process and Policy, October 2010.
https://www.researchgate.net/publication/235273186_Value_of_people's_participation_for_good_governance_in_developing_countries
- [Judith E. Innes](#) & [David E. Booher](#), "**Reframing public participation: strategies for the 21st century**", October, 2007.
<https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/1464935042000293170?scroll=top&needAccess=true>
- Th. Bureekul, "**Good Governance as a new way of republic administration: perspectives from Thailand**", 2000.
https://www.academia.edu/7976118/GOOD_GOVERNANCE_AS_A_NEW_WAY_OF_PUBLIC_ADMINISTRATION_PERSPECTIVES_FROM_THAILAND
- Doracak për kryetarët e komunave dhe për anëtarët e këshillave të komunave në Republikën e Maqedonisë. <https://www.osce.org/sq/skopje/15631?download=true>
- Ligji për vetëqeverisje lokale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 5 nga viti 29.01.2002).
<https://veles.gov.mk/veles3/images/stories/pdf/zakon%20za%20lokalna%20samouprava.pdf>
- Ligji për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, numër 61/2004, 96/2004, 67/2007, 156/2009, 47/11, 192/15)
http://aa.mk/WBStorage/Files/Zakon_finansiranje_edinicite_lokalnata_samouprava.pdf

- Ligji për buxhetet („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “, numër 64/2005, 04/2008, 103/2008, 156/2009, 95/10, 180/11, 171/12, dhe 192/15).
<https://www.finance.gov.mk/files/u6/5.pdf>
- Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “, nr. ”.13/2006, 86/2008, 6/10, 42/14, 148/15).
- http://www.stat.gov.mk/pdf/SlobodenPristapDoInformacii/zakon_za_informacii.pdf
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë Veriore
<https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/UstavSRSM.pdf>
- Ligji për realizimin e buxheteve të Republikës së Maqedonisë për 2012, 2013, 2014
- Trenovski dhe Memeti. Doracak për modulin 1: ROLI I KËSHILLAVE KOMUNALË NË QEVERISJEN E MIRË. Agjencioni Zvicran për zhvillim dhe kooperim dhe UNDP.
[file:///C:/Users/s.aliya.SEEU/Downloads/MODUL%201_Uloga%20na%20opshtinskite%20soveti_ALB%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/s.aliya.SEEU/Downloads/MODUL%201_Uloga%20na%20opshtinskite%20soveti_ALB%20(1).pdf)
- A. Aliu, **“Procesi i decentralizimit dhe vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë, pas marrëveshjes kornizë të Ohrit”**, Tetovë: UEJL - Fakulteti i Administratës Publike, 2008.
- A. Aliu, E. Stavileci, **“Qeverisja lokale”**, Tetovë, Universiteti i Evropës Juglindore, 2009.
- Statuti I Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë, Shkup, 11 Dhjetor, 2015.
- Doracak për përgatitjen dhe implementimin e Partneriteteve publiko-private (PPP) efektive, Shkup, Dhjetor 2007.
- BNJVL Monografi – 40 vite në shërbim të komunave, Dushica Perishiq, -1972-2012.
- Standardet e pushtetit local efektiv dhe demokratik-Standarde Lidere, Risto Ravanovski, Shkup 2007.

- Unë dhe komuna ime - Doracak për procesin e decentralizimit në Republikën e Maqedonisë, Daniela Andreska ,Nikolla Jovanovski,Gjorgji Vellkovski, Shkup 2008.
- Doracak për ecurinë Administrative të procedurës Administrative në fushën e menaxhimit financiar, Marjan Nikolov, Nëntor 2007.
- Doracak për përgatitjen dhe implementimin e Partneriteteve publiko-private (PPP) efektiv, Miroslav Trajanovski, Danço Uzunov, Marjan Nikollov, Jane Vrtesk,Dhjetor 2008.
- Udhezues për procedurë në veprimtaritë Komunale për njësit e vetëqeverisjes lokale, Neol Konsalt Georgi Hristov Dragan Hristov ,Tetor 2008.
- Qeverisja e mirë: Projekti për e-Qeveri – Përkrahje për institucionet për futjen e standardeve, (2010-2011).
- Koncept për qendrat Komunale për shërbime: Mision dhe roli.
- Adresar i Komunave në Republikën e Maqedonisë, Sasho Klekovski, Akleksandar Krzhallovski.
- Doracak për ecurinë Administrative të procedurës Administrative në fushën e veprimtarive Komunale, Jonçe Cvetkovski, Nentor 2007.
- Qeverisja e mirë, A. Lacej, Maj 2010.
- Bashkëpunimi ndërkomunal në Republikën e Maqedonisë, Shkup, nëntor 2015.
- Rajonet e planifikuara në Republikën e Maqedonisë, Enti Shtetëror i Statistikës, Shkup 2011.

Shtojca:

PYETËSOR

Me qëllim që të mundemi të ndikojmë në përmirësimin e qeverisjes në funksion të menaxhimit të mire të komunës së Bogovinës, është i nevojshëm mendimi i juaj.

Përgjigjuni në të gjitha pyetjet me ndershmëri.

Të gjitha përgjigjet e pyetësorit janë anonime dhe do të trajtohen si të besueshme.

Ju lutemi

- Lexojeni secilën pyetje me kujdes/Прочитайте го внимателно секое прашање
- Klikoni numrin që korrespondon me nivelin e pajtueshmërisë suaj

P1: A jeni të informuar rreth formave të pjesëmarrjes së banorëve (Referendum, mbledhje të banorëv, iniciativat e banorëve) në vendimarrjen e komunës së Bogovinës?

1. Po
2. Jo
3. Refuzon të përgjigjet (**NUK LEXOHE**T)
4. Nuk e dinë (**NUK LEXOHE**T)

P2: A e dini se cili është kryetari i komunës suaj?

1. Po
2. Jo
3. Refuzon të përgjigjet (**NUK LEXOHE**T)
4. Nuk e dinë (**NUK LEXOHE**T)

P3: Si e vlerësoni efikasitetin e funksionimit të komunës së Bogovinës?

- Shumë efikas
- Pjesërisht efikas
- Pjesërisht joefikas
- Plotësisht joefikas

- Refuzon të përgjigjet (**NUK LEXOHE**T)
- Nuk e dinë (**NUK LEXOHE**T)

P4: Deri më tani:

NJË PËRGJIGJE NË SECILËN RADHË

		Po	Jo
P4_1	Kam marrë pjesë në Këshillin e komunës	1	2
P4_2	Kam marrë pjesë në mbledhjen e banorëve	1	2
P4_3	Kam marrë pjesë në Referendumin e organizuar nga komuna	1	2
P4_4	Kam paraqitur një procedure ose propozim në komunë	1	2

P5: A keni qenë të konsultuar rreth shqyrtimit të rregulloreve të komunës së Bogovinës (strategjitë, programet, planet, vendimet, etj)?

1. Po
2. Jo
3. Refuzon të përgjigjet (**NUK LEXOHE**T)
4. Nuk e dinë (**NUK LEXOHE**T)

P6: Sa jeni të motivuar të përfshiheni në punët nga interesi komunal në nivel lokal?

- Plotësisht të motivuar
- Të motivuar
- Po thujse jo të motivuar
- Plotësisht jo të motivuar
- Refuzon të përgjigjet (**NUK LEXOHE**T)
- Nuk e dinë (**NUK LEXOHE**T)

P7: A keni marrë pjesë në vendosjen e prioriteteve të komunës së Bogovinës?

1. Po
2. Jo
3. Refuzon të përgjigjet (**NUK LEXOHE**T)
4. Nuk e dinë (**NUK LEXOHE**T)

P8: Si informoheni për funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës? (pyetje me më shumë mundësi përgjigjeje)

P8_1	1	Nga buletini i komunës
P8_2	2	Nga ueb faqja e komunës së Bogovinës

P8_3	3	Nga mediumet lokale
P8_4	4	Nga shtypi lokal
P8_5	5	Nga njoftimi i komunës së Bogovinës
P8_6	6	Nga buletini i shtypur i komunës së Bogovinës
P8_7	7	Nga buletini i lagjes/komunitetit
P8_8	8	Nga mbledhjet dhe debatet publike
P8_9	9	Të tjera

P9: Ju lutemi na thuani nëse pajtoheni me deklaratën vijuese: Banorët informohen në lidhje me funksionimin punën e Komunës së Bogovinës (pyetje me më shumë mundësi përgjigjeje)

- Plotësisht pajtohem
- Pajtohem
- As pajtohem, as edhe nuk pajtohem
- Nuk pajtohem
- Aspak nuk pajtohem
- Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHE)
- Nuk e dinë (NUK LEXOHE)

P10: A mendoni se ka nevojë për organizimin e zyrave të Komunës së Bogovinës?

1. Po
2. Jo
3. Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHE)
4. Nuk e dinë (NUK LEXOHE)

P11: Si e vlerësoni efikasitetin e funksionimi të komunës së Bogovinës:

NJË PËRGJIGJE NË SECILËN RADHË

		Plotësisht joefikas	Pjesërisht joefikas	Pjesërisht efikas	Plotësisht efikas	Nuk e di
P11_1	Kryetari	1	2	3	4	99
P11_2	Këshilli, anëtarët e këshillit	1	2	3	4	99
P11_3	Administrata komunale	1	2	3	4	99
P11_4	Shërbimet e inspektimit komunal	1	2	3	4	99

P12: Si e vlerësoni transparencën në funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës?

- Shumë transparent
- Pjesërisht transparent
- Pjesërisht jo transparent
- Plotësisht jo transparent
- Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHE)
- Nuk e dinë (NUK LEXOHE)

P13. Çfarë duhet të ndërmerret që të rritet transparenca në komunën e Bogovinës?

PYETJE ME SHUMË PËRGJIGJE

P13_1	1	Takime më të shpeshta me banorët
P13_2	2	Shpallja e të gjitha informacioneve në ueb faqen e komunës së Bogovinës
P13_3	3	Shpallja në gazetën komunale
P13_4	4	Komunikim elektronik me komunën
P13_5	5	Të tjera

P14: A keni dërguar kërkesë për qasje të lirë në informacionet me karakter publik deri në administratën komunale?

1. Po
2. Jo
3. Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHE)

P15: Në cilën mënyrë do të dëshironit të merrni informacione për funksionimin (punën) e komunës së Bogovinës? (pyetje me mundësi me më shumë përgjigje)

- Nga ueb faqja e komunës
- Nga buletini i komunës
- Të tjera
- Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHE)
- Nuk e dinë (NUK LEXOHE)

P16: Cilët informacione do të dëshironit në mënyrë të detyrueshme t'i shpallni në ueb faqen e komunës? (pyetje me mundësi me më shumë përgjigje)

PYETJE ME SHUMË PËRGJIGJE

P16_1	1	Buxheti dhe raportet financiare
P16_2	2	Informacione për projektet që implementohen nga komuna e Bogovinës
P16_3	3	Informacione për të gjitha shërbimet që komuna i siguron nga shabllonat e kërkuara
P16_4	4	Informacione mbi ndërmarrjet në pronësi publike dhe ndërmarrjet e krijuara
P16_5	5	Informacione shërbyese
Q17_6	6	Друго, запиши

ASPEKTI DEMOGRAFIK

D1: Gjinia

- Femërore
- Mashkullore

D2: Moshë

_____ vite

D3: Përkatësia etnike

- Shqipëtar
- Maqedon
- Të tjerë

D4: Niveli i arsimimit

1. Bazik
2. Mesëm
3. Sipëror